

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 5 tetor 2012

ISSN 2225-2959

9 772225 295004



EUROBONOT E THESARIT
Evolucioni në zhvillim



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

AAB ofron për bankat anëtare një mundësi me kosto të ulëta për trajnimin e punonjësve.



ANËTARËT E AAB

ALPHA BANK	BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE	CREDINS bank	CBA CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT TE SHQIPTARE
CRÉDIT AGRICOLE	Fibank First Investment Bank	Banka Nderkombetare Tregtare International Commercial Bank	INTESA SANPAOLO BANK Albania
NBG Bank	ProCredit Bank	Raiffeisen BANK	SOCIETE GENERALE ALBANIA
TIRANA BANK	UNION BANK	UBA United Bank of Albania Banka e Bashkuar e Shqiptare	VENETO BANKA GRUPPO VENETO BANCA

Përmbajtja

EDITORIAL

Eurobonot e thesarit - Evolucionimi në zhvillim
nga *Elvin MEKA*

f.5

TEMA E DITËS

Bonot shqiptare të thesarit në euro-
një risi apo një vazhdimësi?

f.6

SISTEMI BANKAR

A dhanë hua bankat? Sigurisht!
nga *Seyhan PENCABLIGIL*

f.10

Bankat, fajtojnë pse janë fitimprurëse?
nga *Ersuin SHEHU*

f.11

Ndryshimet në legjislacionin tatimor fiskal dhe ndikimi i
tyre në aktivitetin dhe efikasitetin bankare
nga *Aleko POLO*

f.13

FORUMI I EKSPERTËVE

Grabitja e bankave dhe rreziku psikosocial
nga *Roland TASHI*

f.17

Sigurimet tradicionale dhe ndikimi i tyre
në sistemin financiar nga *Enkeleda SHEHI*

f.19

Studimet Master, pëballë zhvillimit të karrierës
dhe tregut të punës nga *Luljeta MINXHOZI*

f.21

Cilësia e stafit dhe përvoja bankare
nga *Anila DENAJ*

f.22

KËNDI I EKONOMISTIT

"Libogate" - dritëhijet e një manipulimi të rrezikshëm
bankar nga *Adrian CIVICI*

f.25

PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE

RRJETI BALLKANIK

Lajme ndërballkanike

f.32

TEKNOLOGJI

M - Pay, gati për të lançuar pagesat përmes celularit
në Shqipëri nga *Ludovic LAVETURE*

f.37

AUDITORI FINANCIAR

Komiteti i menaxhimit të aktiv - pasiveve, ALCO,
komiteti më i rëndësishëm bankar nga *Ejlon TAÇE*

f.39

AAB

Shoqata Shqiptare e Bankave për zhvillimin e burimeve
njerëzore

f.42



BANKIERI është publikimi më
i ri zyrtar i Shoqatës Shqiptare
të Bankave i cili do t'i dedikohet
kryesisht sektorit bankar shqiptar.
BANKIERI do t'i japë lexuesit
një informacion të vlefshëm mbi
arrijet e industrisë në përgjithësi
dhe të bankave tregtare në
veçanti.

Bankieri

Nr. 5, tetor 2012

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Redaksia:

Elvin Meka

Kryeredaktor

Ersuin Shehu

Bashkëpunëtor

Juna Katroshi (Tafaj)

Koordinatorë Produksioni

Sonila Krashi

Design & Layout

Besa Vila

Redaktore

Gert Hoxha

Fotograf

Shtypi:  Gentgrafik

Bordi Editorial:

Seyhan PENCABLIGIL

Kryetar i AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm,
Banka Kombëtare Tregtare

Ioannis KOUGIONAS

Nënkryetar i AAB - së & Drejtor i Përgjithshëm,
NBG Bank

Christian CANACARIS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së &
Drejtor i Përgjithshëm, Raiffeisen Bank

Flutura VEIPI

Anëtare e Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtuese e
Drejtorisë Ekzekutive, Procredit Bank

Bozhidar TODOROV

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm
Banka e Parë e Investimeve - Shqipëri

Periklis DROUGKAS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm
Alpha Bank Albania

Endrita XHAFERAJ

Sekretare e Përgjithshme, Shoqata Shqiptare e Bankave

Hysen ÇELA

Menaxher, NH EuroConsult

Adrian CIVICI

President & Drejtor i Shkollës Doktorale
Universiteti Europian i Tiranës

Spiro BRUMBULLI

Rektor - Tirana Business University

Enkeleda SHEHI

Kryetare e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", KULLAT BINJAKE
Kulla I, Kati 6-të, A3, Tiranë

Tel: +355 4 2280 371; Fax: +355 4 2280 359

E-mail: bankieri@aab-al.org; www.aab.al

15 VJET
PËRKUSHTIM
NDAJ SECILIT PREJ
100.000
KLIENTËVE TANË



NBG Bank
Tradicionalisht e besueshme

EUROBONOT E THESARIT – EVOLUCIONI NË ZHVILLIM



nga Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

Deri më tani, qeveria ka përmbushur me sukses pjesën e parë të procesit të evolucionit: financimin e nevojave të saj në euro, por tregjet dhe pjesëmarrësit e tij presin dhe do të kërkojnë më shumë prej saj... ata do të kërkojnë më shumë tregtueshmëri dhe likuiditet për këtë instrument, duke pasur parasysh kufizimet e bankave për të investuar në to, sikurse edhe gjetjen e kundërpalëve aktive, në një treg dytësor modest, ose që thajse nuk ekziston aspak.

Qeveria shqiptare mbetet përsëri në qendër të vëmendjes; duke nuhatur fort momentin dhe situatën e duhur ajo zgjodhi dhe përdori mekanizmin e përsosur. Në kulmin e kësaj vere të nxehtë që kaluam, ajo emtoi një produkt “të nxehtë” financiar: bonot e thesarit në euro për publikun e gjerë investues. Faktikisht, ky nuk ishte një produkt dhe aq “fringo”, pasi qeveria emtoi të tilla bono që në mesin e vitit 2010 e përsëri dhe në fund të vitit që kaloi, gjithsesi pa publicitet dhe pa marketing. Ajo që ishte krejtësisht e re këtë herë lidhej me publicitetin energjik dhe me përqendrimin në mënyrë publike të një bazë e caktuar investuese: publiku i gjerë. Sigurisht, kjo bazë investuese shkëlqeu në pjesëmarrjen e saj për blerje bonosh, pasi rezultatet e ankandëve ishin më shumë se të shkëlqyera, ku kërkesa tejkaloi ofertën.

Për qeverinë shqiptare ky është një tjetër hap përpara, në drejtim të diversifikimit të portofolit të borxhit të saj, përtej detyrimeve në monedhën kombëtare (Lek). Gjithsesi, bonot e thesarit në euro, nga pikëpamja e natyrës së detyrimeve, nuk janë një risi, por bashkudhëtare të euroobligacioneve dhe bonove të thesarit në Lek. Prania e një instrumenti të tillë duket krejt e natyrshme për tregun dhe për vetë pjesëmarrësit e tij, përfshirë këtu dhe bankat, të cilat shohin tashmë një produkt financiar, në monedhë të huaj, “konkurrent” me produktet e tyre. Megjithatë, depozitat bankare në monedhë të huaj (euro) kanë pozitë të fortë në treg dhe përbëjnë një produkt natyral për investuesit, ndërkohë që eurobonot e thesarit shihen ende si një produkt i veçantë dhe në madhësi tepër të vogël,

krahasuar me depozitat bankare. Gjithashtu, edicionet e emetimit të këtyre bonove nuk pritet të jenë në vëllime të mëdha, pasi përgjithësisht qeveritë qendrore i sigurojnë fondet e mëdha, në monedhë të huaj, nëpërmjet emetimit të detyrimeve sovraane afatmesme dhe afatgjatë, duke përdorur tregjet ndërkombëtare.

Pavarësisht nga madhësia modeste e tyre në treg, eurobonot e thesarit janë tashmë në treg dhe përbëjnë praktikisht një alternativë tjetër investimi për publikun e gjerë, duke i dhënë kështu tregut më shumë ngjyra. Deri më tani, qeveria ka përmbushur me sukses pjesën e parë të procesit të evolucionit: financimin e nevojave të saj në euro, por tregjet dhe pjesëmarrësit e tij presin dhe do të kërkojnë më shumë prej saj. Konkretisht, ata do të kërkojnë më shumë tregtueshmëri dhe likuiditet për këtë instrument, duke pasur parasysh kufizimet e bankave për të investuar në to, sikurse dhe gjetjen e kundërpalëve aktive në një treg dytësor modest, ose që thajse nuk ekziston fare. Gjithashtu, siç e theksojnë dhe vetë bankierët (shihni seksionin TEMA E DITËS), informimi, edukimi financiar dhe transparenca janë elemente thelbësore për investuesit, me qëllim që ata të marrin vendime të pjekura, por dhe të informohen për rreziqet e mundshme që shoqërojnë investimin në të tilla letra me vlerë.

Thellimi i sistemit financiar, zhvillimi i tregut dhe informimi do të jenë pikërisht karburanti që do të mbajë ndezur dhe në lëvizje mekanizmin e qeverisë që do të mundësojë evolucionin në zhvillim të sistemit financiar shqiptar.

¹ Përgjegjës i Departamentit të Financës, UET

BONOT SHQIPTARE TË THESARIT NË EURO

Një risi apo një vazhdimësi?

Intervistë e disa bankierëve, dhënë kryeredaktorit të revistës “BANKIERI”

P1: Këtë verë qeveria shqiptare shiti, në tregun e brendshëm të borxhit, bono thesari në euro për publikum e gjerë investues. Zakonisht, detyrimet e borxhit në monedhë të huaj financohen nëpërmjet euroobligacioneve (Eurobonds) ose nëpërmjet obligacioneve sovrane. A përbën kjo një mënyrë të re, për grumbullimin e fondeve në monedhë të huaj në tregun e brendshëm, apo ky është një mekanizëm normal financimi nga ana e qeverive qendrore?

HUBERT DE SAINT JEAN,

Mendoj se kjo përbën një mënyrë normale të cilën qeveritë qendrore e përdorin për grumbullimin e fondeve në monedhë të huaj, me qëllim përmbushjen apo shlyerjen e detyrimeve të tilla si: shlyerja pjesore ose e plotë e borxhit të jashtëm, pagesat në favor të investuesve të huaj, që i kërkojnë pagesat në monedhë të huaj, operacionet që lidhen me politikën monetare, etj.

CHRISTIAN CANACARIS,

Përdorimi i këtij instrumenti është më se normal. Shumë vende e përdorin atë kryesisht për dy arsye: për diversifikimin e klientëve të tyre dhe për të arritur te klienti individual.

PERIKLIS DROUGKAS,

Kjo nuk është mënyrë e re financimi, por pjesë e strategjisë së një qeverie për të menaxhuar borxhin publik nëpërmjet diversifikimit të portofolit të borxhit, monedhave dhe mbajtësve të këtij borxhi, etj. Borxhi i brendshëm publik i qeverisë stimulon financimet në dobi të qytetarëve, e njëkohësisht rrit sovranitetin e saj nëpërmjet zvogëlimin të nivelit të borxhit, që zotërohet nga investuesit ose nga institucionet financiare të huaja, që në kthim ndikon dhe të shpenzimet për intere-

sa për borxhin e huaj. Tregu i titujve në euro po kthehet në një realitet edhe për individët, që deri më tani përdorin vetëm produktet bankare për kursimet e tyre.

ERANDA SHEHU,

Nëpërmjet një politike huamarrje të kujdesshme mendoj se qeveritë qendrore mund të marrin borxh në monedhë të huaj edhe në tregjet e tyre lokale. Kjo politikë ndikohet nga një kombinim faktorësh të rëndësishëm, si: specifikat e tregut financiar lokal dhe të gatishmërisë së pranisë të investuesve të huaj, nëpërmjet pjesëmarrjes në emetimet në tregjet financiare ndërkombëtare. Gjithsesi, në kushtet e krizës shumëdimensionale, që ka mbërthyer tregjet ndërkombëtare, një emetim i dytë Eurobondi në tregjet ndërkombëtare, nga ana e qeverisë sonë, mund të rezultojë me kosto shumë të larta. Le të jemi realistë, kriza e borxheve që ka mbërthyer shumë nga vendet e eurozonës, përveç të tjerave erdhi edhe si rrjedhojë e faktit se këto qeveri fillimisht i “thënë” plotësisht likuiditetet e vendit të tyre duke u orientuar më pas drejt tregjeve ndërkombëtare për të siguruar likuiditetet e tjera të nevojshme.



...nisur nga niveli i informalitetit dhe i mungesës së informacionit në Shqipëri, transparencja dhe informimi i publikut do të ndihmonte në ndërtimin e një kulture “të të qenit i informuar” në Shqipëri, gjë kjo shumë e dobishme për të gjithë investuesit në të ardhmen.

Hubert de Saint Jean,
Drejtor i Përgjithshëm,
Société Générale



P2: Nga pikëpamja teknike natyra e detyrimit të borxhit është e njëjtë, paçka se shprehet në lek apo në euro (borxh qeveritar); gjithsesi ato ndryshojnë në tipare të tjera si për shembull: profilet e rreziqeve. Cilat janë rreziqet e mundshme që zakonisht shoqërojnë detyrime të tilla borxhi?

HUBERT DE SAINT JEAN,

Rreziku kryesor në këtë rast është ai i kursit të këmbimit. Zakonisht, euroobligacionet janë tituj afatgjatë e për rrjedhojë, një rivlerësim afatgjatë i monedhës së huaj mund të dëmtojë qeverinë në momentin e shlyerjes së pagesave. Nga ana tjetër, një zhvlerësim i saj do të ndikonte negativisht tek investuesit, e duke qenë se këto janë obligacione qeveritare një situatë e tillë mund të krijonte një klimë jo të këndshme.

CHRISTIAN CANACARIS,

Dallimi kryesor qëndron te lloji i monedhës. Klienti ose blerësi i një titulli të tillë mund të ndeshet me rrezikun e kursit të këmbimit, në rast të zhvlerësimit të euro-s. Për sa i përket rreziqeve të tjera nuk ka dallime mes tyre.

PERIKLIS DROUGKAS,

I vetmi element shtesë (duke supozuar se të gjitha elementet e tjera përbërëse janë të njëjta) është pikërisht

rreziku i kursit të këmbimit, si për qeverinë, ashtu dhe për mbajtësit e këtij detyrimi në monedhë të huaj.

ERANDA SHEHU,

Një element specifik i rëndësishëm në drejtim të rreziqeve potenciale, që shoqërojnë investimin te letrat me vlerë të borxhit të qeverisë shqiptare në monedhë të huaj, është rreziku i monedhës, ose i ndryshimit të kursit të këmbimit valutor, që mund të ndikojë negativisht në aftësitë paguese të qeverisë shqiptare. Një tjetër aspekt është rreziku i likuiditetit, që lidhet me tregtimin e këtyre titujve në tregun dytësor. Nëse një investues dëshiron të tregtojë (shesë) bono thesari në monedhë të huaj, duhet të përballlet me faktin nëse bankat si ndërmjetësit financiarë më të specializuar, mund ta blejnë ose jo një titull të tillë, fillimisht të kushtëzuara nga kufijtë e brendshëm, ose nga ato të vendosura nga rregullatorët.



Klienti ose blerësi i bonove të thesarit në euro mund të ndeshet me rrezikun e kursit të këmbimit, në rast të zhvlerësimit të euro-s. Për sa i përket rreziqeve të tjera nuk ka dallime mes tyre.

Christian Canacaris,
Drejtor i Përgjithshëm,
Raiffeisen Bank

P3: Sipas jush, a përbën ky hap një sinjal apo ndihmon në drejtim të thellimit financiar, ose në zhvillimin e tregut financiar shqiptar?

HUBERT DE SAINT JEAN,

Sigurisht, bonot e thesarit janë aktualisht i vetmi investim në letra me vlerë në tregun shqiptar dhe kjo është mundësuar vetëm në monedhë kombëtare.

Këto bono në euro janë pa dyshim një zhvillim që do të ketë dy ndikime pozitive: së pari, publiku do të ketë mundësi të investojë në të ashtuquajturit tituj "pa rrezik" edhe në monedhë të huaj dhe së dyti, do të jetë një mundësi e mirë që publiku të familjarizohet me investimet në monedhë të huaj (përveç depozitave) e më tej të orientohet drejt tregjeve të tjera të huaja jashtë vendit për investime në tituj të tjerë në të ardhmen.

CHRISTIAN CANACARIS,

Ky është një zhvillim shumë pozitiv në Shqipëri. E gjykoj më se të nevojshme që klientëve duhet t'u ofrohen lloje të ndryshme instrumentesh. Arsyeja kryesore lidhet me diversifikimin e rreziqeve. Tregu shqiptar duhet të zhvillohet dhe të ndjekë të njëjtat prirje si edhe tregjet e tjera për sa i përket instrumenteve financiare. Sigurisht, duhet punuar në drejtim të edukimit të publikut.

PERIKLIS DROUGKAS,

Ky mund të jetë një tregues që tregu financiar shqiptar po bëhet më dinamik dhe i gjerë në të gjithë dimensionet e tij.

ERANDA SHEHU,

Emetimi i letrave me vlerë të qeverisë shqiptare në monedhë të huaj mund të sjellë ndryshime cilësore në zhvillimin e mëtejshëm të tregut financiar në drejtim të: (1) rritjes së aktivitetit të ndërmjetësimit në letrat me vlerë të qeverisë shqiptare, duke zgjeruar më tej bazën e investuesve rezidentë, duke mundësuar diversifikimin e investimeve të klientëve në monedhë të huaj, si dhe të palëve me të cilët hyjnë në transaksion, (2) ofrimit të hapësirave për shoqëritë administruese të sipërmarrjeve kolektive, apo fondeve të pensioneve vullnetare, që të ofrojnë shërbimet e tyre në monedhë të huaj dhe (3) rritjen e pranisë së investuesve të huaj në Shqipëri.



Partneri juaj për Agrobiznes

Për kredi deri në 2 000 000 lekë
Ofertë speciale për garancinë

E vlefshme për afate deri në tre vjet

www.procreditbank.com.al

P4: A janë bonot shqiptare të thesarit në euro një investim tërheqës për bankat?

HUBERT DE SAINT JEAN,

Sigurisht, bonot e thesarit në euro janë një mundësi interesante investimi, veçanërisht për ato banka që dëshirojnë të ofrojnë një platformë të gjerë të investimeve vendëse për klientët e tyre.

CHRISTIAN CANACARIS,

Ky është një instrument interesant veçanërisht për ato banka që duan të diversifikojnë rrezikun e kursit të këmbimit, por dhe të investojnë fondet e tyre në monedhë të huaj.

PERIKLIS DROUGKAS,

Bonot e thesarit në euro përbëjnë një alternativë fitimprurëse investimi për bankat, por meqenëse ky instrument nuk konsiderohet si aktiv likuid në përlllogaritjen e treguesve të likuiditetit, bankat janë shumë të kujdesshme për të investuar në tituj qeveritarë në euro.

P5: Transparenca dhe informimi i publikut janë tiparet kyçe për një treg financiar të shëndetshëm dhe të fortë. Meqenëse këto bono po i ofrohen drejtpërdrejt publikut të gjerë investues, a mendoni se është e nevojshme që kjo ofertë duhet të shoqërohet me një fushatë të informimit të publikut?



Nëse një investues dëshiron të tregtojë (shesë) bono thesari në monedhë të huaj, duhet të përballlet me faktin nëse bankat si ndërmjetësit financiarë më të specializuar, mund ta blejnë ose jo një titull të tillë, fillimisht të kushtëzuara nga kufijtë e brendshëm, ose nga ato të vendosura nga rregullatorët.

Eranda Shehu,

Drejtoresh e Departamentit të Thesarit dhe anëtare e ALCO-s, Tirana Bank

ERANDA SHEHU,

Për bankat kjo paraqet një mundësi investimi të një pjese të tepricave të likuiditetit në monedhë të huaj, në bonot e thesarit të emetuara nga qeveria shqiptare, dhe kjo si në terma të kthimit nga investimi, ashtu dhe në aspektin e afatit të investimit. Gjithsesi, kjo mbetet një mundësi e kufizuar për bankat, pasi siç e cilësova, për “një pjesë të tepricave të likuiditetit në monedhë të huaj”, investime të tilla, që ndikohen veçanërisht nga rreziku i këmbimit, kushtëzohen kryesisht nga dy faktorë shumë të rëndësishëm, si:

- (1) kuadri rregullator i Bankës së Shqipërisë, që kufizon pjesëmarrjen e bankave në instrumente të tilla dhe
- (2) bankat mëmë, që mund të ndërtojnë politika të shtrënguara përkundrejt investimeve të tilla

HUBERT DE SAINT JEAN,

Po, duke pasur parasysh dhe përvojat jo të këndshme të publikut shqiptar në të kaluarën (nga skemat piramidale), duhet të ofrohen shpjegime dhe detaje të plota për publikun e interesuar, me qëllim që këto tituj në monedhë të huaj të jenë tërheqës e njëkohësisht të sigurt për investuesit. Nga ana tjetër, nisur nga niveli i informalitetit dhe i mungesës së informacionit në Shqipëri, një gjë e tillë do të ndihmonte në ndërtimin e një kulture “të të qenit i informuar” në Shqipëri, gjë kjo shumë e dobishme për të gjithë investuesit në të ardhmen.

CHRISTIAN CANACARIS,

Siç e përmenda dhe më parë, shitja e këtyre produkteve financiare kërkon një nivel të caktuar edukimi financiar dhe ky proces edukimi duhet të fillojë tashmë. E gjykoj të nevojshme që klientëve duhen t’u shpjegohen rreziqet që shoqërojnë këto instrumente e kjo është e domosdoshme jo vetëm për bonot e thesarit, por për të gjitha llojet e reja të instrumenteve financiare. Bankat janë pjesë e këtij procesi dhe janë klientët ata që vendosin në fund.



Borxhi i brendshëm publik i qeverisë stimulon financimet në dobi të qytetarëve, e njëkohësisht rrit sovranitetin e saj nëpërmjet zoogëlmit të nivelit të borxhit, që zotërohet nga investuesit ose nga institucionet financiare të huaja, që në kthim ndikon dhe të shpenzimet për interesa për borxhin e huaj.

Periklis Drougkas,
*Drejtor i Përgjithshëm,
Alpha Bank*

PERIKLIS DROUGKAS,

Interesi gjithnjë në rritje i qytetarëve për të investuar në bono thesari në euro u rrit nga 1.8 milionë euro në ankandin e dhjetorit të vitit 2011 dhe në 9.85 milionë euro në ankandin e fundit të zhvilluar në gusht të këtij viti. Ky është një tregues i qartë i ndikimit të fushatës masive për marketing, organizuar nga Ministria e Financave, por dhe e ndërgjegjësimit të qytetarëve për mundësitë e investimit në titujt qeveritarë.

ERANDA SHEHU,

Sigurisht që po! Një nga strategjitë kryesore të menaxhimit të borxhit publik është rritja e bazës së investuesve, për rrjedhojë, është shumë e rëndësishme transparenca në drejtim të ofrimit të një informacioni të detajuar mbi karakteristikat e titullit të borxhit, mbi rreziqet kryesore që ai paraqet dhe për trajtimin tatimor që në kthim lejon një kuptim më të thellë të këtyre instrumenteve.

A DHANË HUA BANKAT? SIGURISHT!¹



nga Seyhan PENCABLILIGIL,
Drejtor i Përgjithshëm,
Banka Kombëtare Tregtare
Kryetar i AAB-së

Sot jemi shumë të lumtur që autoriteti mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë, po bashkëpunon me një nga bankat qendrore më të vjetra e më zhvilluara në botë: Bankën e Italisë. Jam i sigurt se një bashkëpunim i tillë është me përfitim reciprok e në çdo rast do të ndihmojë në zbatimin e praktikave më të mira. Si një gjysmë i huaj, më duhet të shtoj se ndërveprimi në të kaluarën midis Italisë dhe Shqipërisë ka qenë në pjesën dërrmuese me përfitim për këtë të fundit.

Duke përfituar nga rasti dhe nga prania e medias, dëshiroj të nënvizoj disa fakte të rëndësishme për sistemin bankar shqiptar. Kohët e fundit, në rrethet e caktuara, qarkullojnë shpesh dy histori, që: (1) bankat nuk po japin hua dhe (2) bankat po fitojnë shumë në kurriz të klientëve të tyre. Le t'i marrim dhe t'i analizojmë një nga një të dyja këto. Sistemi bankar shqiptar gjatë 12 muajve të fundit rriti aktivitetin e tij me 12.9 për qind. Kjo është një rritje e madhe, nisur nga stanjacioni në sektorët ose dhe në ven-

Kriza ekonomike nuk do të përfundojë nëse çmimet e aktiveve nuk do të korrektohen, e kjo do të ndodhë vetëm nëse do të ketë zbatim eficient të kolateralit

det e tjera. Bankat gjithashtu krijuan dhe 200 vende të reja pune, ndërkohë që kudo ka shkurtime. A dhanë hua bankat? Po, sigurisht! Stoku i huave bankare u rrit gjatë kësaj periudhe me 13.3 për qind. A po fitojnë bankat në mënyrë të jashtëzakonshme? Jo! Totali i fitimit të sistemit bankar, pra fitimi i agreguar për të 16 bankat e sistemit, ishte vetëm 5 milionë euro për vitin 2011! Nga këndvështrimi i kapitalit që aksionarët e bankave kanë investuar në sistemin bankar shqiptar shuma është domethënëse: 750 milionë euro. Nëse me këtë kapital aksionarët tanë do të kishin blerë, të themi euroobligacionet shqiptare, ata do të kishin fituar gjatë vitit të fundit afërsisht 75 milionë euro. Nëse do të kërkonin investime të sigurta, për shembull, të investonin në obligacione gjermane, ata do të kishin fituar 15 milionë euro. Përkundrazi, ata investuan në bankat shqiptare dhe fituan vetëm 5 milionë euro; e për më tepër, po akuzohen që kanë fituar shumë!

Po pse ky fitim kaq i ulët gjatë vitit të kaluar? Kjo, sepse më shumë se 20 për qind e huamarrësve tanë nuk kanë arritur të shlyejnë huat që morën nga bankat. Pra, problemi nuk qëndron te bankat sepse ato kanë dhënë hua në Shqipëri, por te huamarrësit që nuk po kthejnë paratë që

kanë marrë nga bankat!

Kjo nxjerr në dritë një tjetër çështje të rëndësishme: kur një huamarrës nuk e shlyen huan, bankat duhet të kalojnë në ekzekutim të kolateralit. Fundja ky është dhe kuptimi i kolateralit. Falë Zotit, pjesa dërrmuese e huave bankare është e mirëkolateralizuar. Megjithatë, për shkak të procedurave administrative, ky ekzekutim i kolateralit po bëhet tejet i vështirë. Le ta themi qartë dhe thjeshtë: Kriza ekonomike nuk do të përfundojë nëse çmimet e aktiveve nuk do të korrektohen, e kjo do të ndodhë vetëm nëse do të ketë zbatim eficient të kolateralit. Unë propozoj tri zgjidhje të thjeshta për një ekzekutim eficient të kolateralit: (1) një ankand të tretë, krahas dy të parëve në procesin e ekzekutimit, me çmimin e tregut; (2) gjykata të posaçme dhe/ose gjykatës të trajnuar dhe (3) liberalizimin e tarifave të përmbartimit, ku tarifatat bazë të përmbartimit të mbështeten në funksion të suksesit të tyre. Jemi të vetëdijshëm që disa prej këtyre propozimeve mund të kërkojnë dhe ndryshime ligjore, por tjetër rrugë nuk ka. Kjo është rruga drejt rimëkëmbjes.

Faleminderit për vëmendjen tuaj.

Sistemi bankar shqiptar rriti aktivitetin e tij me 12.9 për qind, gjatë 12 muajve të fundit. Kjo është një rritje e madhe, nisur nga stanjacioni në sektorët apo dhe vendet e tjera. Bankat gjithashtu krijuan dhe 200 vende të reja pune, ndërkohë që në kudo ka shkurtime. A dhanë hua bankat? Sigurisht!

¹ Fjala e mbajtur në tryezën e diskutimit: "Për një sistem bankar të shëndetshëm dhe eficient në Shqipëri", organizuar nga Banka e Shqipërisë dhe Banka e Italisë, në 4 korrik 2012, në Tiranë.

BANKAT, FAJTORE PSE JANË FITIMPRURËSE?

Gjatë muajve të fundit sistemi bankar është përballur me ankesa publike, kryesisht nga përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe nga publiku i gjerë, që shprehen se bankat nuk japin hua, nuk i ndihmojnë bizneset për të kaluar vështirësitë e krizës, dhe se po nxjerrin fitime të majme. Në fakt, pretendime të tilla nuk gjejnë mbështetje të shifrata zyrtare, pasi sipas të dhënave të publikuara nga AAB, në fund të muajit korrik, rritja vjetore e gjithë portofolit të huave ishte 7.8%, ndërsa vetëm në segmentin e bizneseve ishte 12.8%. Gjithashtu, në shtatë muajt e parë të vitit, sistemi bankar arriti një fitim prej 2.7 miliardë lekë, me një rritje rreth 35% ndaj të njëjtës periudhë të një viti më parë.

Përkundrejt "akuzave" se bankat nuk po ndihmojnë biznesin me likuiditet, fakti është se qoftë stoku i huave, qoftë huaja e re, e dhënë gjatë këtij viti, përbëhen në pjesën më të madhe nga paradhënie bankare dhe nga hua për kapital qarkullues për biznesin. Prej disa kohësh, por edhe për shkak të ngadalësimit ekonomik, financimi i bankave ka një horizont më afatshkurtër sesa më parë dhe kjo sepse: (1) projektet serioze dhe cilësore janë më të pakta dhe (2) kemi rritje të rreziqeve në të gjitha ekonomitë, pra natyrshëm dhe në ekonominë shqiptare, si pasojë e krizës ekonomike globale. Kjo e fundit sigurisht që ka rritur nivelin e kujdesit të bankave, kujdes që pasqyrohet jo vetëm në angazhimin e bankave në financime më afatshkurtra, por dhe në çmimet e shërbimeve apo produkteve bankare, të cilat logjikshëm duhet të përlllogarisin në kostot e tyre dhe çmimin shtesë të rrezikut të aktivitetit ekonomik që ato mbështesin.

Fakti pozitiv që duhet të evidentohet është se bankat po vijnë të mbështesin me hua ekonominë, pavarësisht rreziqeve të shtuara, por askush nuk mund të pretendojë që çdo biznes në vështirësi të trokasë në bankë dhe të përftojë patjetër

Ekzistenca e bankave fitimprurëse nuk është aspak një e keqe, por një e mirë e madhe për ekonominë, sepse bankat fitimprurëse janë banka më të forta, më të sigurta dhe në gjendje t'i shërbejnë më shumë ekonomisë përmes ndërmjetësimit financiar.

hua. Bankat janë shoqëri tregtare me qëllime fitimi dhe, ç'është më e rëndësishme, administrojnë kursimet e publikut të gjerë. Në kushtet kur ekonomia përkeqësohet dhe huat me probleme rriten, kujdesi i shtuar është gjëja më normale që mund të ndodhë, për më tepër kur sot është imperativ një sistem bankar i sigurt dhe i aftë për të mbështetur ekonominë. Por, ndërkohë që bankat vazhdojnë të financojnë ekonominë, ndaj tyre ka edhe të tjera "akuza" për fitime dhe/ose interesa tepër të larta. Por a është ky një fitim i lartë dhe a ka ardhur falë interesave të larta? Sipas AAB-së, në fund të muajit korrik, sistemi bankar kishte një kthim nga kapitali prej 4.7% dhe një kthim nga aktivet prej 0.4%, norma kthimi këto që nuk mund të klasifikohen si të larta. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për interesat. Sistemi bankar ka ndjekur politikën monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë, madje kjo politikë është pasqyruar te interesat e huave, në mos më shumë se ato të depozitave. Krahasuar me një vit më parë, bankat kanë një marzh interesi më të ulët me-

satarisht me 0.3 pikë përqindjeje.

Nëse, për fat të mirë, fitimet e sistemit bankar këtë vit janë rritur, kjo sigurisht që nuk ka ardhur nga rritja e interesave, por në radhë të parë nga një ecuri më e qëndrueshme e kredive me probleme. Kjo sjell më pak shpenzime për provigjione dhe rezultat më të mirë financiar; kësaj i shtohet dhe një kontroll më i kujdesshëm i shpenzimeve operative, çka shkurton kostot.

Në këto kushte, ekzistenca e bankave fitimprurëse nuk është aspak një e keqe, por një e mirë e madhe për ekonominë, sepse bankat fitimprurëse janë banka më të forta, më të sigurta dhe në gjendje t'i shërbejnë më shumë ekonomisë përmes ndërmjetësimit financiar. Fitimet janë një burim i çmuar për mirëkapitalizim, po të kemi parasysh se në këto kohë për akcionarët nuk është e lehtë dhe e dëshirueshme të injektojnë kapitale shtesë, siç është kërkuar dhe po kërkohet nga autoritetet rregullatore. Ndaj, tingëlton e pazakontë të fajësohen sot bankat pse ato janë fitimprurëse!

nga Ersuin SHEHU



RAIFFEISEN RELAKS



Një bankë për të gjithë brezat

Raiffeisen Relaks:
Pagesa automatike
Depozita me Afat
... dhe shumë të tjera



**Raiffeisen
BANK**

www.raiffeisen.al

NDRYSHIMET NË LEGJISLACIONIN TATIMOR FISKAL DHE NDIKIMI I TYRE NË AKTIVITETIN DHE EFIÇENCËN BANKARE



nga Aleko POLO
Drejtor Financiar,
Tirana Bank

Situata ekonomike aktuale në S vend sigurisht që ka ndikimet e veta të drejtpërdrejta në sektorin bankar. Një nga treguesit e këtij sektori, i ndikuar negativisht, është cilësia e portofolit të huave, ku vërehet një përkeqësim i tij, sidomos gjatë vitit të kaluar dhe që gjithashtu vijon edhe në vitin ushtrimor ku ndodhemi. Sigurisht, në këto rrethana, bankat marrin masa jo vetëm për përmirësimin e cilësisë së huave me probleme, por njëkohësisht dhe për mbrojtjen e këtyre huave nëpërmjet krijimit të rezervave speciale ose provizioneve. Këto rezerva (ose ky fond), shërbejnë për të kompensuar, në një periudhë të ardhshme, një vlerë potencialisht të humbur, si për kryegjënë e huas, ashtu edhe për interesin.

Bankat, në bazë të ligjit nr.9228, dt. 29.04.2004 "Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", duke filluar nga 1 janari i 2008-ës, janë të detyruara të përgatisin dhe të raportojnë pasqyrat financiare në përputhje me SNRF-të¹. Gjithashtu, ato

Shkelja dhe mosrespektimi i parimeve dhe i metodologjive përkatëse të kontabilizimit dhe raportimit financiar, me qëllim fryrjen artificiale të rezultatit tatimor, do të krijojë probleme dhe më komplekse në të ardhmen.

janë të detyruara t'i përgatisin këto pasqyra edhe sipas legjislacionit shqiptar (standardeve kombëtare) dhe rregulloreve të Bankës së Shqipërisë. Kjo procedurë bazohet në ligjin nr. 9662, dt.18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe në rregulloren përkatëse të Bankës së Shqipërisë. Duke i krahasuar të dyja standardet me njerëzjetrin vërehet se, për zëra të njëjtë në paraqitjen e pasqyrave finan-

ciare përkatëse, mund të ketë diferencën në raportim. Këto diferencë vijnë si rezultat i metodologjive të ndryshme që përdorin standardet në përlllogaritjen e këtyre zërave. Provigjonet janë një nga zërat ku diferencën midis dy standardeve është e konsiderueshme. Duke u bazuar në SNRF-të, provizionet e huave përlllogariten duke marrë në konsideratë pagesat e pritshme (rrjedhën e parasë), të argumentuara sipas situatën në të cilën ndodhet klienti dhe sipas strategjisë së bankës për të rikuperuar detyrimin. Vetë këto pagesa të pritshme bazohen në një mundësi reale të një marrëveshje pagese, ose ristrukturimi dhe në pamundësi të tyre, nëpërmjet rrjedhës së pritshme të të ardhurave nga ekzekutimi i detyrueshëm i garancive të huave. Ndërkohë, sipas standardeve kombëtare, provizionet përlllogariten duke marrë në konsideratë klasifikimin e huave sipas pesë kategorive dhe normave të këtyre fondeve rezervë (provizionet), për mbulimin e humbjeve nga huat për secilën kategori. Nga ana e tyre, këto kategori huash krijohen duke u bazuar te ditë-vonesat në shlyerjen e huas dhe në gjendjen financiare të huamarrësit.

Qëllimi i sigurimit të një baze tatimore më të madhe e përkatësisht dhe të një rezultati tatimor sa më të lartë, nuk mund të justifikojë zbatimin e një metodologjie të luhatshme provizionimi nga një periudhë në tjetrën.

¹Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS).

Shpenzimet për provizione dhe legjislacioni tatimor.

Vitet e fundit legjislacioni tatimor në Shqipëri lidhur me marrjen parasysh të provizioneve ka pësuar një ndryshim të veçantë, ndryshim që në vitet në vijim do të ketë ndikime thelbësore në çështjen e hartimit dhe të raportimit të pasqyrave financiare bankare. Në parantezë, duhet të përmendet se, deri në fund të vitit 2010, neni 25 i ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat" përcaktonte se: "Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm vjetor, janë shpenzime të njohura provizionet e bankave, të krijuara sipas rregullave të Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim. Shumat e rimarra nga këto rezerva ose provizione i shtohen fitimit të tatueshëm". Në vijim, në dhjetor të vitit 2010, po në këtë nen të këtij ligji bëhet një ndryshim i veçantë, që hyri në fuqi në janar të vitit 2011. Sipas këtij ligji tashmë përkufizimi i provizioneve të bankave merr një kuptim tjetër, dhe konkretisht ky nen përcakton që: "Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të bankave, janë shpenzime të njohura, provizionet e bankave të krijuara në përputhje me standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare Kontabël dhe të certifikuara pa vërejtje nga auditues të jashtëm, por në çdo rast, pa tejkaluar masën e përcaktuar të rregullat e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim. Shumat e rimarra nga këto rezerva ose provizione i shtohen fitimit të tatueshëm".

Thënë më thjesht, në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të bankave, do të njihen si shpenzime për provizione, herë provizionet e përlogaritura në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe herë provizionet e krijuara për qëllime statutores (sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë), ku gjithnjë do të njihen si shpenzime të zbritshme shuma më e vogël e provizioneve të krijuara nga të dy standardet.

Nga pikëpamja teknike dhe profesionale një përcaktim i tillë është i pakuptimtë dhe paraqet probleme për zbatimin në praktikë gjatë viteve ushtrimore në vijim. Problemi i parë lidhet me mosmarrjen parasysh të logjikës së vazhdimësisë dhe të njëtrajtshmërisë (konsistencës) në



raportimin e pasqyrave financiare në vite; element thelbësor ky i hartimit dhe i raportimit të pasqyrave financiare. Qëllimi i sigurimit të një baze më të madhe tatimore e përkatësisht dhe të një rezultati tatimor sa më të lartë, nuk mund të justifikojë zbatimin e një metodologjie të luhatshme provizionimi nga një periudhë në tjetrën. Më së paku, ky ndryshim në legjislacionin tatimor përveçse i hartuar me "urgjencë", mbetet larg praktikave përkatëse dhe tashmë të vendosura në botë. Duke u nisur nga realiteti, mund të konstatohet lehtësisht që metodologjia e përdorur nga Banka e Shqipërisë për përlogaritjen e provizioneve është më konservatore dhe si rrjedhojë fondi i provizioneve, i krijuar në këtë rast, është më i lartë sesa fondi i provizioneve që krijohet sipas SNRF-ve. Sigurisht, zbatimi nga ana e Bankës së Shqipërisë i një metodologjie të tillë, pra jo në vlerën e kolateraleve ose pagesave të pritshme, mbështetet në kushtet reale ekonomike dhe sociale, duke marrë parasysh vështirësitë e mundshme në materializimin e këtyre elementeve (ekzekutimin e kolateraleve dhe realizimin e pagesave të pritshme). Kështu, ajo logjikshëm

kërkon që fondi i provizioneve të jetë më "agresiv". Ky aspekt është marrë parasysh nga Autoriteti Tatimor deri në 2010-ën, por një gjë e tillë duhet të vijojë. Nga ana tjetër, një metodologji e luhatshme e përlogaritjes së provizioneve për efekte tatimore, krijon pështjellim dhe pabarazi në trajtimin fiskal të rezultateve financiar të sistemit bankar. Le ta shohim më teknikisht problemin me një shembull të thjeshtë.

Supozojmë se në një bankë gjatë vitit 2011, përveç zërit të provizioneve, në pasqyrën e shpenzimeve dhe të ardhurave, të gjitha elementet e tjera kanë qenë të barabarta, sipas të dyja standardeve. Supozojmë gjithashtu që, banka ka fitim para provizioneve dhe para tatimeve në masën 100 milionë lekë. Sipas standardeve kombëtare (BSH) banka për këtë vit ka krijuar provizione të reja (shpenzime) për një portofol të caktuar huash në masën 15 milionë lekë, ndërkohë që nuk ka rimarrje provizionesh, ndërsa sipas SNRF-ve, banka ka krijuar provizione të reja (shpenzime), po për këtë portofol, në masën 5 milionë lekë, dhe gjithashtu nuk ka rimarrje provizionesh.

Përmbledhtazi kemi: (tab. 1)

Tabela 1

	BSH	SNRF
Fitimi para provizioneve dhe para tatimeve	100 milionë	100 milionë
Provizione (rimarrje)	0	0
Provizione (shpenzime)	(15) milionë	(5) milionë
Fitimi para tatimeve	85 milionë	95 milionë

Në këtë rast, duke marrë në konsideratë, për të dyja standardet, të gjitha elementet e tjera në pasqyrën e shpenzimeve dhe të të ardhurave konstante përveç provizioneve, rezultojnë që rezultati tatimor, sipas BSH-së është 85 milionë lekë dhe sipas SNRF-ve është 95 milionë lekë. Në këtë rast, tatimi nga fitimi (me normë tatimi prej 10%) është 9.5 milionë lekë, pasi ky është varianti ku provizionet janë më të vogla. Le të shohim se çfarë ndodh në fund të vitit 2012, nëse deri në fund të këtij viti banka, sipas BSH-së, do të ketë rimarrje provizionesh në masën 15 milionë lekë dhe provizione të reja, po në masën 15 milionë lekë, ndërsa sipas SNRF-ve do të ketë rimarrje provizionesh në masën 1 milion lekë dhe provizione të reja në masën 5 milionë lekë. Duke supozuar se edhe për këtë vit rezultati para provizioneve dhe para tatimeve është 100 milionë lekë dhe elementet e tjera janë të gjitha të njëjta në pasqyrën e shpenzimeve dhe të të ardhurave (ashtu siç u përmend më lart), atëherë do të kemi këtë gjendje: (tab. 2)

Tabela 2

	BSH	SNRF
Fitimi para provizioneve dhe para tatimeve	100 milionë	100 milionë
Provizione (rimarrje)	15 milionë	1 milion
Provizione (shpenzime)	(15) milionë	(5) milionë
Fitimi para tatimeve	100 milionë	96 milionë

Në këtë moment lindin dy probleme për përcaktimin e saktë dhe të drejtë të rezultatit tatimor. Në parantesë, sipas BSH-së, shuma neto e provizioneve të vitit 2012 është zero, ndërkohë që sipas SNRF-ve kjo shumë është -5 milionë lekë. Sipas BSH-së shuma e shpenzimit të provizioneve është 15 milionë lekë, kurse sipas SNRF-ve kjo shumë është 5 milionë lekë.

Problemi i parë:

Cili variant do të merret tashmë për bazë, për përcaktimin e fitimit tatimor: do të merren provizionet për neto (sipas BSH-së janë më të vogla), apo do të krahasohen vetëm shpenzimet e provizioneve (sipas SNRF-ve janë më të vogla) dhe do të anashkalohen rimarrjet e provizioneve? Për dijeni, nga Autoriteti Tatimor nuk ka asnjë udhëzim të qartë për këtë çështje, prandaj inspektorët të ndryshëm tatimorë japin interpretime të ndryshme.


Problemi i dytë:

Nëse për vitin 2012, për përcaktimin e fitimit tatimor do të merret në konsideratë varianti sipas BSH-së

(provizionet për neto), atëherë fitimi i mbetur për t'u shpërndarë në formë dividendi, ose për t'u kapitalizuar rezultojnë i tatuar dy herë për provizionet e rimarra. Kjo sepse, siç është e njohur, burimi i dividendëve për t'u shpërndarë, ose i fitimit për t'u kapitalizuar, bazohet në rezultatin sipas BSH-së. Kjo është e padrejtë! Konkretisht, në vitin 2011 për përcaktimin e fitimit tatimor u bazuam në shumën 5 milionë lekë të provizioneve (sipas SNRF-ve) dhe jo në shumën 15 milionë lekë (sipas BSH-së) dhe si rezultat fitimi tatimor u rrit 10 milionë lekë, duke i krahasuar të dyja variantet. Ndërkohë, në vitin 2012, rimarrja e provizioneve në shumën 15 milionë lekë trajtohet si e ardhur dhe përsëri tatohet. Të tilla ngatërresa mund të shfaqen dhe të interpretohen në mënyra të ndryshme edhe në ato raste kur kemi të bëjmë me fshirje të huave të keqija nga bilanci i bankës.

Në mbyllje, dëshiroj të tërheq vëmendjen se ky ndryshim në legjislacionin tatimor, që ka ardhur nga mosrespektimi i parimit të vazhdimësisë në trajtimin dhe në paraqitjen e pasqyrave financiare, të cilat gjatë zbatimit prodhojnë probleme dhe devijime logjike, parimore, metodologjike dhe praktike, ka krijuar një pështjellim të pazakontë brenda sistemit bankar. Çdo shkelje dhe mosrespektim i parimeve dhe i metodologjive përkatëse të kontabilizimit dhe të raportimit financiar, me qëllimin e vetëm për ta fryrë artificialisht rezultatin tatimor, do të krijojë probleme edhe më komplekse në të ardhmen si në rrafsh institucional ashtu edhe në atë të sistemit, duke vënë në vështirësi vetë Autoritetin Tatimor, por dhe duke i hapur rrugë abuzimit dhe subjektivizmit.

Në këto kushte, mbetet imperativ rishikimi i një ndryshimi të tillë, duke synuar ndjekjen e një metodologjie të vetme për përllogaritjen e rezultatit të tatueshëm, me qëllim që pasqyrat financiare të bëhen normalisht të lexueshme dhe të krahasueshme në kohë.



KREDI PËR SHTËPI



ZGJIDHENI SHTËPINË ME ZEMËR DHE BANKËN ME MENDJE

VITI I PARË 6% FIKS. NË VAZHDIM EURIBOR + 4.5%, MIN 6%.
OFERTA ËSHTË E VLEFSHME PËR PERIUdhËN 8 TETOR - 31 DHJETOR 2012.

SE BASHKU FORCOJME SHPIRTIN E SKUADRES



**SOCIETE GENERALE
ALBANIA**

GRABITJA E BANKAVE DHE RREZIKU PSIKOSOCIAL



nga Roland TASHI
Zëvendëskryetar

Komiteti i AAB-së për Sigurinë Bankare

Vlerësimi i rrezikut të grabitjes dhe i akteve të tjera me natyrë kriminale në sistemin tonë bankar ende nuk përcaktohet si kusht ligjor për punëdhënësin në këto institucione, pasi legjislacioni bankar, dhe jo vetëm ai, nuk parashikon detyrime në këtë fushë. Pavarësisht nga ky fakt, duke iu referuar terrenit në të cilin zhvillojnë veprimtarinë bankat, si edhe statistikave të organeve të zbatimit të ligjit, ngarkesës së ngjarjeve, veprimeve abuzive e kriminale ndaj punonjësve të këtij sistemi, vlerësimi i rrezikut të grabitjes dhe vjedhjes duhet të përbëjë një nga detyrimet kryesore të strukturave drejtuese të bankave.

Vlerësimi i rrezikut është një proces i rëndësishëm dhe i nevojshëm, pasi ai ndikon te një nga qëllimet kryesore të punëdhënësit, që duhet të jetë dhe një nga objektivat kryesorë të tij në mbrojtjen e integritetit psikofizik të punonjësve. Grabitja e bankave dhe e institucioneve të tjera financiare konsiderohet vepër kriminale, që shoqërohet me pasoja të natyrës psikofizike, jo vetëm për punonjësit dhe klientët e gjendur në skenën e kriminit, por edhe më gjerë sepse ngjarja provokon, ndikon dhe i bën të ndjeshëm të gjithë punonjësit e sistemit bankar. Precedenti i grabitjes krijohet

Vlerësimi i rrezikut është një proces i rëndësishëm dhe i nevojshëm, pasi ndikon te një nga qëllimet kryesore të punëdhënësit, që duhet të jetë dhe një nga objektivat kryesorë të tij, në mbrojtjen e integritetit psikofizik të punonjësve.

në mënyrë të “pavullnetshme”, pasi ai nxitet nga natyra e veprimtarisë së bankave, ku lëndë e parë dhe produkt është vetëm paraja. Psikologët, punonjësit socialë dhe struktura të veçanta e njohin fenomenin dhe pasojat psikologjike të shkaktuara nga grabitja, prandaj themi se jemi ende larg përcaktimit të saktë të nivelit të traumës dhe dëmtimit të shkaktuar. Grabitja, vjedhja dhe akte të tjera abuzive, nuk mund të perceptohen dhe të shoqërohen me të njëjtat pasoja të karaktere të ndryshme njerëzore; përcaktimi i saktë i pasojave të grabitjes nga njëri individ tek tjetri ka nevojë për analiza dhe diagnostikime specifike mjekësore.

Tema e prekur kërkon pa dyshim

Niveli i traumës dhe i stresit të shkaktuar është i lidhur jo vetëm me ashpërsinë dhe tipin e ngjarjes së jetuar, por dhe me elemente të tjera, si: karakteristika të personalitetit, elemente të natyrës sociale, aftësia e përballimit të ngjarjeve të rënda, etj.

argumente dhe angazhim të specialistëve të sigurisë dhe psikologë të fushës, por një fakt është i dukshëm që, dëmtime më të rënda psikologjike pësojnë ata individë të cilët janë pjesë dhe “aktorë” të një skene krimi, ku kriminelët për arritjen e qëllimit përdorin armët e zjarrit dhe dhunën; kështu ngjarja shoqërohet me lëndime, me plagosje ose me humbje jete. Statistikat tregojnë se në pjesën më të madhe të grabitjes së bankave në vendin tonë, kriminelët përdorin armët e zjarrit për të bërë presion psikologjik mbi ata individë që nuk veprojnë sipas “urdhrave” të tyre; në të kundërt i dëmtojnë sepse grabitja duhet të kryhet në një kohë sa më të shkurtër. Te këta individë, pas traumës së parë mund të krijohen dhe të zhvillohen shqetësime të natyrës së stresit dhe të ankthit. Në mënyrë të përmbledhur po japim, tri grupet kryesore të simptomave, të shenjave kryesore të shqetësimeve posttraumatike: (1) përjetimi i ngjarjes dhe i traumës nëpërmjet kujtimeve të çasteve më të vështira të saj dhe sjelljes në kujtesë se ngjarja mund të përsëritet, (2) këmbëngulja për të evituar stimuljt, ngacmimet që lidhen me ngjarjen, duke iu larguar veprimtarive, vendeve, si dhe personave që janë të lidhur me ngjarjen dhe (3) prania e shqetësimeve që krijojnë vështirësi në fjetje, mungesë përqendrimi, nervozizëm të panevojshëm, etj.

Një numër i madh individësh mund të ballafaqohen dhe të jenë të pranishëm në ngjarje dhe në situata të rënda kriminale, por jo të gjithë shoqërohen me pasoja dhe shqetësi-

me stres. Nëse i referohemi traumës psikologjike, që shkakton ngjarja, lidhur me grupindividët e gjendur brenda bankës, grabitja përbën një fenomen kompleks sepse në mjedisin e brendshëm gjenden jo vetëm punonjësit e bankës, por dhe klientët e vizitorët të moshave të ndryshme, mes të cilëve në disa raste dhe fëmijë. I gjithë ky grup individësh rrezikohet të ketë pasoja psikologjike, ku pa dyshim punonjësit e bankës janë më të "ndjeshmit", pasi vendngjarja është e lidhur me vendin e tyre të punës, të cilin ata do ta frekuentojnë edhe pas ngjarjes. Pasoja psikologjike, të shkaktuara nga grabitja, mund të rëndohen dhe të shfaqen si në planin emocional, përmes perceptimit të pasigurisë lidhur me vendin e punës, po ashtu edhe me shfaqjen e ndjenjës së mosbesimit, veçanërisht ndaj personave të panjohur më parë.

Për parandalimin e rrezikut të grabitjes dhe për zvogëlimin e traumave të shkaktuara nga ngjarja, strukturat drejtuese të bankave duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme. Këtu është shumë e rëndësishme të kryhen studime e kërkime nga specialistët të sigurisë, ose nga grupe të zgjeruara pune, në përbërje të cilave të ketë edhe psikologë për të parë format, mënyrat, teknikat e grabitjes me qëllim që të evitohen pasojat e mundshme dhe të merren masat mbrojtëse. Planifikimi i trajnimeve të rregullta dhe me tematika të veçanta, që lidhen me grabitjen, duhet të vlerësohet si një proces i rëndësishëm, por dhe kryesor për

...është shumë e rëndësishme të kryhen studime e kërkime nga specialistët të sigurisë ose nga grupe të zgjeruara pune, në përbërje të cilave të ketë edhe psikologë për të parë format, mënyrat, teknikat e grabitjes, me qëllim që të evitohen pasojat e mundshme dhe të merren masat mbrojtëse.

Planifikimi i trajnimeve të rregullta dhe me tematika të veçanta, që lidhen me grabitjen, duhet të vlerësohet si një proces i rëndësishëm dhe kryesor për rritjen e sigurisë fizike dhe psikologjike në mjedisin e punës.

rritjen e sigurisë fizike dhe psikologjike në mjedisin e punës. Trajnimet e fokusuar te këto tematika duhet të jenë pjesë e politikave të një menaxhimi të suksesshëm dhe duhen konsideruar jo thjesht si kosto, por para së gjithash si investim që ndikon në mbrojtjen e punonjësve nga traumat e shkaktuara prej grabitjes. Gjithashtu, është e nevojshme që punëdhënësi, dhe jo vetëm ai në sistemin bankar, të informojë të gjithë punëmarrësit për rreziqet që lidhen dhe që shfaqen gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij në vendin e punës e mbi bazë të saj të merren masat e duhura për trajnimin e tyre në mënyrë që ky rrezik së pari të njihet e më pas të minimizohet. Me pak fjalë, kultura e njohjes dhe e ndër-gjegjësimit duhet të zëvendësojë kulturën e bindjes dhe të detyrimit. Në terrenin aktual, ku bankat zhvillojnë aktivitetet e ku krimi shfaqet perio-

dikisht, duke krijuar një trysni psikologjike, kjo dhe për efektin që krijon media gjatë pasqyrit të ngjarjeve të ngjashme në biznese financiare e tregtare, siguria në vendin e punës duhet të jetë së pari kulturë e të gjithë punonjësve. Trajnimi nuk duhet vlerësuar si proces i kushtëzuar nga ligji, ose nga politikat dhe nga standardet e brendshme të bankës, por si një instrument dhe mundësi më shumë, nëpërmjet të cilit promovohet dhe rritet kultura e sigurisë, që ndikon pozitivisht në përballimin e traumave dhe në uljen e rrezikut psikosocial. Duhet kuptuar se në zinxhirin e masave dhe të proceseve të sigurisë, qenia njerëzore mbetet një nga hallkat më të dobëta dhe delikate, pasi individit përballet fizikisht dhe psikologjikisht me krimin. Ai vazhdon të mbartë e të pasqyrojë për një kohë të gjatë goditjen psikologjike, nëpërmjet përjetimit të ngjarjes. Investimi tek elementet teknologjike të sigurisë si: mbrojtja nëpërmjet sistemeve elektronike, përdorimi i hyrjeve të kontrolluara në objektet bankare, etj, është dhe mbetet një faktor kryesor dhe mbizotërues në raport me produktin e sigurisë që përfitohet nga shërbimet me punonjës sigurie. Perceptimi i realitetit pa rrumbullakosje dhe pa interpretime si dhe harmonizimi sa më i mirë i faktorëve teknologjikë e njerëzorë, mund të japë rezultate të kënaqshme në drejtim të sigurisë. Është shumë e rëndësishme të krijohet bindja se nëpërmjet njohjes së fenomenit dhe masave të marra, mund të mbrohemi nga grabitja dhe nga pasojat psikologjike post saj.



SIGURIMET TRADICIONALE DHE NDIKIMI I TYRE NË SISTEMIN FINANCIAR



nga Enkeleda SHEHI
Kryetare
Autoriteti i Mbikëqyrjes
Financiare, AMF

Shoqëritë e sigurimit kryejnë një funksion të rëndësishëm në ekonomi, duke mundësuar që agjentët ekonomikë të blejnë mbrojtje kundrejt rreziqeve, që në kushte të tjera nuk mund të mbrohen. Në këtë mënyrë, ato plotësojnë tregjet financiare, duke ofruar instrumente për mbrojtjen ndaj rreziqeve. Një sigures tradicional e ndërton modelin e tij të biznesit rreth grumbullimit të primeve dhe zbatimit të një politike të caktuar të shpërndarjes së aktiveve, duke u ndihmuar nga instrumentet e tregjeve financiare për rritjen e kthimeve nga investimi. Synimi i këtij aktiviteti investues është ndërtimi i një baze aktivi, që do t'i mundësojë siguruesit përballimin e dëmeve të ardhshme, të cilat janë të panjohura në vlerë, por dhe në kohë.

Në tregun e sigurimeve në Shqipëri operojnë njëmbëdhjetë shoqëri sigurimesh, nga të cilat shtatë shoqëri të sigurimit të Jo-Jetës, dy shoqëri të sigurimit të Jetës dhe një shoqëri kompozitë e Jetës dhe Jo-Jetës. Tregu i sigurimeve në Shqipëri, si një treg tradicional, është i orientuar kryesisht nga sigurimet motorike, të cilat zënë rreth 55% të totalit të të ardhurave të tregut të sigurimit të Jo-Jetës. Ndërsa sigurimi i Jetës, që zë rreth

9.65% të totalit të primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve, vazhdon të jetë i lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të huadhënies, kryesisht për individët. Të ardhurat e tregut për vitin 2011 arritën në shifrën rreth 8.4 miliardë lekë. Primi i sigurimit për frymë në Shqipëri është mesatarisht 2,901 lekë, ndërsa primet e shkruara të sigurimit zënë rreth 0.62% të PBB-së. Kjo tregon që tregu i sigurimeve është ende larg një tregu të maturuar, por që mbart potenciale, për të arritur minimalisht nivelin e rajonit.

Modeli i biznesit të siguruesve

Tregu i sigurimeve bashkëvepron me tregun bankar në disa aspekte, të cilat mund të përbëjnë edhe drejtimet nëpërmjet të cilave mund të transferohen rreziqet brenda sistemit financiar në tërësi.

Ekziston një konsensus, që biznesi tradicional i sigurimeve ka pak mundësi për të qenë burim i rrezikut sistematik, pasi aktiviteti tradicional i sigurimeve përbën shumë pak ose aspak shqetësim për sistemin financiar

dallon nga ai i bankave. Arsyet e këtyre dallimeve, për sa i takon efektin, kanë të bëjnë me veçantitë e modelit tregtar të sigurimeve, i cili në ndryshim nga bankat nuk varet nga financimi afatshkurtër. Nga ana tjetër, këto dallime lidhen me zbatimin e disiplinuar të një qasjeje për investimet kryesisht të orientuar nga pasivet, me natyrën e dëmeve, që në shumë raste mundësojnë administrimin e rrjedhave dalëse monetare gjatë një periudhe të gjatë kohore (nga javë në muaj e deri në vite, në varësi të produktit). Natyra e rezervave teknike dhe fakti se pagesat që u bëhen policëmbajtësve në përgjithësi kërkojnë ndodhjen e ngjarjes së siguruar, e bën më pak të mundshme që siguruesit e përfshirë në veprimtari tradicionale të pësojnë dalje të befasishme monetare, që do t'i shteronin mjetet e tyre likuide.

Tregu i sigurimeve bashkëvepron me tregun bankar në disa aspekte, të cilat mund të përbëjnë edhe drejtimet nëpërmjet të cilave mund të transferohen rreziqet brenda sistemit financiar në tërësi.

Rreth 55.7 % të totalit të aktiveve të tregut të sigurimeve mbahen në depozita me afat në sistemin bankar se në bono thesari, përfshi këtu edhe depozitat e Fondit të Garancisë.

Tregu i sigurimeve në Shqipëri si një treg tradicional është i orientuar kryesisht nga sigurimet motorike, të cilat zënë rreth 55% të totalit të të ardhurave të tregut të sigurimit të Jo-Jetës.



Mundësia e siguruesve për të bërë investime të tilla përbën një ndihmesë të rëndësishme për stabilitetin financiar të bankave dhe të sistemit financiar në përgjithësi. Ecuria e portofolit të pronës dhe sigurimi i jetës së debitorit janë të lidhura drejtpërdrejt me ecurinë e huadhënies nga bankat, pasi zhvillimi i këtyre produkteve ndikohet drejtpërdrejt nga kërkesat e bankave për sigurim. Referuar të dhënave të sistemit bankar, rreth 45% e huave është e kolateralizuar me pasuri të paluajtshme, sigurimi i të cilës realizon një tjetër ndërlidhje midis tregut të sigurimeve dhe tregut bankar.

Klasa e sigurimit të huas, për të cilën licencohen shoqëritë e sigurimit përbën një tjetër mundësi për transferimin e rrezikut ndërmjet sistemit bankar dhe atij të sigurimeve. Sigurimi i huas mund të marrë forma të ndryshme, që nga huaja konsumatore, deri te sigurimi i garancisë bankare. Pavarësisht nivelit jo të kon-

siderueshëm të të ardhurave nga ky produkt, është e qartë që ai përbën potencial të madh të transferimit të rrezikut nga sistemi bankar në tregun e sigurimeve. Nga argumentet e mësipërme, pavarësisht se niveli i aktiveve të tregut të sigurimeve është ende i ulët, instrumentet që ofron ky treg paraqesin potencial me prirje rritëse të ndërveprimit midis tregut bankar dhe atij të sigurimeve.

Ekziston një konsensus, që biznesi tradicional i sigurimeve ka pak mundësi për të qenë burim i rrezikut sistematik. Kjo, pasi aktiviteti tradicional i sigurimeve përbën shumë pak ose aspak shqetësim për sistemin financiar. Për këtë ka një sërë arsyes, siç janë rrjedhat e qëndrueshme të primeve dhe mosvarësia të financimi afatshkurtër, apo flukset monetare që janë të parashikueshme për një periudhë kohore relativisht të gjatë dhe të gjitha këto arsye bëjnë që veprimtaritë tradicionale të sigurimeve të mos ndikojnë në këtë sistem.

Klasa e sigurimit të huas, për të cilën licencohen shoqëritë e sigurimit përbën një tjetër mundësi për transferimin e rrezikut ndërmjet sistemit bankar dhe atij të sigurimeve. Sigurimi i huas mund të marrë forma të ndryshme, që nga huaja konsumatore, deri te sigurimi i garancisë bankare.

STUDIMET MASTER, PËRBALLË ZHVILLIMIT TË KARRIERËS DHE TREGUT TË PUNËS



nga Prof. Dr. Luljeta MINXHOZI
Zv. Rektore,
Dekane e Fakultetit Ekonomik &
Drejtoare e Programeve Master
Universiteti European i Tiranës, UET

Sfida e çdo të riu, që kërkon të hyjë në tregun e punës, apo e çdo profesionisti në karrierë është që të jetë gjithnjë e më konkurrues në një mjedis social dhe ekonomik global dhe që ndryshon vazhdimisht. Në këtë përpjekje ne të gjithë i drejtohem dijes, si mjeti më i sigurt që na e krijon këtë mundësi. Por në fakt, tregu i punës nuk kërkon aq sa dimë ne, por sa dimë ta përdorim ne dijen tonë. Pikërisht për t'iu përshtatur kësaj kërkese dhe për të krijuar përparësinë personale në tregun e punës sistemet moderne të edukimit kanë krijuar programet e studimit Master, si mënyra më e mirë që dijet e gjithsecilit t'iu transformojë në motivim dhe inovacion. Për shembull, programet Master në UET janë ndërtuar në mënyrë që të rrisin te studentët aftësinë e të menduarit kritik, aftësinë për t'iu përshtatur me sjelljet reale të shoqërisë, aftësitë e sipërmarrjes dhe të iniciativës, aftësitë e lidhshimit etj. Programet Master kategorizohen në dy grupe: Master i Shkencave dhe Master Profesional.

Programet e studimit Master i Shkencave synojnë që të prodhojnë studiues të ardhshëm për fushat e

E ardhmja e këtyre programeve është ndërveprimi midis fushave të ndryshme të shkencës dhe lidhja me kërkesat e tregut të punës për profesione shumëdimensionale

ndryshme të studimit. Këto programe i aftësojnë dhe iu japin atyre mundësinë që të studiojnë lëndët themelore teorike dhe metodologjike, të cilat do t'iu hapin rrugët për ecur përpara drejt një karrierë të ardhshme akademike. Natyrisht, ndjekja e një programi të tillë është e detyrueshme të vijohet nga ata studentë që aspirojnë të vazhdojnë dhe studimet e ciklit të tretë, pra studimet Doktorale.

Programet e Studimit Master Profesional synojnë të pajisin studentët me njohuritë bazë që krijojnë një profesion universitar dhe si i tillë programi përqendrohet në lëndët e specializuara të profesionit të synuar dhe në një stazh praktik profesional. Ky lloj programi është një nga produktet akademike më fleksibël, në kuptimin që këto programe janë vazhdimisht në proces përshtatje me kërkesat e tregut vendas dhe të zhvillimeve rajonale. Kjo realizohet akademikisht nga ne me anë të lëndëve të profilit, të cilat mund të ndryshohen më lehtë brenda një programi studimi, pa prekur lëndët themelore që krijojnë bërthamën teorike të formimit shkencor të profesionit. Përmbledhtazi, ky program studimi krijohet pikërisht për të krijuar profesione të kryqëzuara gjatë karrierës së një individi. Për shembull: studentët e diplomuar me një Bachelor në shkencë ekonomike mund të vazhdojnë studimet në një Master Profesional në të Drejtë Biznesi ose

një student i diplomuar me një Bachelor në shkencë sociale, të mund të vazhdojë studimet Master Profesional në Administrim Biznesi.

Përputhja e programeve Master me kërkesat e tregut të punës realizohet nëpërmjet Bordeve të Punës, që janë ngritur pranë strukturës akademike përgjegjëse për këto programe dhe që janë dhe urat lidhëse me botën e biznesit. Nëpërmjet tyre ne përqipemi të kuptojmë, që në embrion, kërkesat e tregut të punës për specialitete e profile të reja ekonomistësh dhe t'iu përfshijmë këto profile sa më shpejtë që të jetë e mundur në programet e studimit Master Profesional ose Master i Shkencës. Sigurisht që e ardhmja e programeve Master është ndërveprimi midis fushave të ndryshme të shkencës, si dhe lidhja me kërkesat e tregut të punës për profesione shumëdimensionale, si një nga çelësat e suksesit afatgjatë të këtyre programeve.

PROGRAMET MASTER NË UET:

- 8 programe Master të Shkencave (MSH)
- 2 në Juridik, 4 në Shkencë Sociale dhe 2 në Ekonomik, të ndara në 23 profile;
- Programet MSH organizohen me 120 kredite (ECTS) dhe zgjasin 2 vjet.
- 11 programe Master Profesional (MP)
- 3 në Juridik, 4 në Shkencë Sociale dhe 5 në Ekonomik, të ndara në 22 profile
- Programet MP organizohen në 60 ose 90 kredite (ECTS) me kohezgjatje përkatësisht 1 vit ose 1.5 vjet.

CILËSIA E STAFIT DHE PËRVOJA BANKARE



nga Anila DENAJ
Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive
ProCredit Bank

Zhvillimet ekonomike dhe financiare në Shqipëri, por edhe në tregun ndërkombëtar, kanë krijuar një platformë për krijimin e një mendimi dhe një të plani strategjik që do të mundësojë një përjasje drejt rritjes së kapaciteteve njerëzore, si në kuadrin profesional akademik, ashtu dhe në atë personal, kryesisht drejt përgjegjshmërisë.

Në kontekstin shqiptar, kjo përjasje po merr një rëndësi të madhe, duke marrë si bazë edhe zhvillimet e formimit akademik gjatë viteve të fundit, që jo gjithmonë kanë rezultuar në një rritje të ecurisë cilësore të studentëve që diplomohen. Ajo që vihet re, me keqardhje, është se cilësia, e parë në këtë kontekst, nuk është në rritje. Këto prirje nuk janë përputhur gjithnjë. Institucionet e biznesit ose ato akademike kanë bërë përpjekjet e tyre për të arritur një partneritet, në mënyrë të tillë që të gjendet formati i duhur për ta ndihmuar këtë proces. Konkretisht, në industrinë bankare nevoja për profesionalizëm dhe për përgjegjshmëri vjen edhe bëhet më urgjente. Kriza financiare dhe tregu global, ku operojmë, e thekson edhe më shumë rolin që duhet të marrin bankat dhe rëndësinë e një vendim-marrjeje të përgjegjshme, të bazuar në një gjykim analitik dhe kritik. Pran-

Një staf profesional dhe i përgjegjshëm, që njuh shumë mirë nevojat e biznesit dhe zbaton me përgjegjësi strategjitë e bankës, është edhe garancia drejt suksesit

daj për bankën tonë përzgjedhja e një stafi cilësor, të dedikuar, që beson te vlerat dhe te misioni i saj është mjaft e rëndësishme. Një staf profesional dhe i përgjegjshëm, që njuh shumë mirë nevojat e biznesit dhe zbaton me përgjegjësi strategjitë e bankës, është edhe garancia drejt suksesit. Për të krijuar këtë cilësi dhe përgjegjshmëri banka jonë ka investuar në programin “Bankierët e rinj”.

Një pjesë e mirë e studentëve që marrin pjesë në këtë program për-

zgjidhen nga studentët që zhvillojnë praktikën mësimore në bankën tonë gjatë periudhës së studimeve universitare. Ky plan i ndihmon sistemin tonë të rekrutimit dhe i shkon në ndihmë edhe zhvillimit praktik të studentëve. Suksesi i praktikave mësimore dhe i programit që ne ofrojmë nuk duhet parë i lidhur vetëm me interesat që një shoqëri mund të ketë drejt punësimit. Përzgjedhja bëhet në bazë të ecurisë së tyre në planin teorik, me një mesatare mbi notën tetë. Një përzgjedhje e tillë përcakton një fillim të mbarë mes shoqërisë dhe studentit, për të garantuar një program internship-i të suksesshëm për ata studentë, ku cilësia është një objektivi i prekshëm. Studentët duhet të kenë vullnetin që të marrin sa më shumë njohuri në drejtimin praktik, të kenë aftësi dëgjuese dhe të diskutojnë hapur në lidhje me paqartësitë që kanë, të jenë aktivë gjatë gjithë periudhës së praktikës dhe të jenë të interesuar për të marrë maksimumin, por dhe për të ofruar njohuritë që kanë.

Programi “Bankierët e rinj” është një program unik, i dizenuar nga një staf akademik në Gjermani dhe që synon të përfshijë persona me përvojë pune si dhe studentë që kanë mbaruar studimet universitare, por dhe që kanë dëshirën dhe vullnetin që të fitojnë njohuri të reja.

Përgjegjësia e institucionit zgjerohet më tej në atë se si orientohet praktika mësimore. Shpesh, mënyra si zhvillohet praktika e punës, është jofunksionale për qëllimin e paracaktuar, pra marrjen e njohurive të duhura praktike. Në këtë kontekst, praktika e punës “përkthehet” në një certifikatë që konfirmon pjesëmarrjen në praktikë, ndërkohë që praktikanti nuk merr dimensionin praktik të asaj që është trajtuar në teori. Çdo student, që zhvillon praktikën e punës në bankën tonë, ka në dispozicion një kontratë dhe një plan-



praktike të mirëpërcaktuar. Gjatë gjithë periudhës së praktikës së punës, praktikantët janë nën përgjegjësinë e një stafi të dedikuar dhe me përvojë në bankë. Banka ofron praktikë mësimore edhe për studentët që nuk përzgjidhen, ose që kanë interes për programin “Bankierët e rinj”, por ata duhet të kenë një mesatare të lartë notash në universitetet, me të cilin ne kemi një marrëdhënie të nënshkruar më parë.

Në këtë program, pjesëmarrja është më e gjerë sesa thjesht studentët. Kandidatët e programit janë persona të përzgjedhur për të mundur një marrëdhënie shërbimi pas

përfundimit me sukses të programit dhe mund të jenë pa ose me përvojë të ndryshme, jo domosdoshmërisht të lidhur me sistemin bankar. Programi “Bankierët e rinj” është një program unik, i dizenuar nga një staf akademik në Gjermani, që synon të përfshijë persona me përvojë pune si dhe studentë që kanë mbaruar studimet universitare, por që kanë edhe dëshirën dhe vullnetin që të fitojnë njohuri të reja. Nëpërmjet këtij programi, pjesëmarrësit kanë mundësinë të përfitojnë njohuri të përgjithshme mbi sistemin bankar dhe për mënyrën si operon ai. Programi është një mundësi si për pjesë-

Shpesh, mënyra se si zhvillohet praktika e punës, është plotësisht jofunksionale për qëllimin e paracaktuar, pra marrjen e njohurive të duhura praktike.

Programi “Bankierët e rinj”: Struktura dhe përmbajtja

<i>Etika, vlera e të menduarit dhe filozofia e biznesit të ProCredit</i>	
Mjedisi ku operojmë <ol style="list-style-type: none"> 1. Shoqëria 2. Perspektiva e zhvillimit 3. Globalizimi dhe mjedisi 	ProCredit <i>si organizatë ekonomike, politike dhe shoqërore & Mënyra jonë e punës dhe roli ynë në sistemin bankar</i>
Sistemi bankar <ol style="list-style-type: none"> 1. Sektori financiar, bankat dhe bankingu 2. Krizat financiare dhe ekonomike 	

marrësit, ashtu edhe për bankën ProCredit, për të vlerësuar nëse aftësitë dhe kërkesat personale përputhen me mënyrën e veçantë të punës së bankës sonë. Cilësia e programeve të trajnimit dhe metodologjia koherente që përdoret ndihmon që të sigurohet një shërbim cilësor dhe i qëndrueshëm kundrejt klientëve. Programi ka një dimension shumë të gjerë dhe zhvillohet për një periudhë kohore 6 mujore, ku ofrohen kurse shumë dinamike dhe ndërvepruese, të shoqëruara me diskutime të hapura midis kandidatëve, sikurse dhe shumë projekte, punë në grup dhe praktikë pune në degët dhe në njësitë e biznesit të bankës.

**KREDI PËR
SHTËPI**

Është koha për shtëpinë tuaj!

**Financim i shpejtë dhe norma interesi
shumë të favorshme.**

www.tiranabank.al

PIRAEUS BANK GROUP

**TIRANA
BANK**
tani mundesh

“LIBORGATE” – DRITËHIJET E NJË MANIPULIMI TË RREZIKSHËM BANKAR



nga Prof. Dr. Adrian CIVICI
President & Drejtor i Shkollës
Doktorale
Universiteti European i Tiranës, UET

Moria e problemeve financiare, monetare e bankare që po shkakton kriza financiare globale, muajt e fundit u përball edhe me një manipulim të rrezikshëm bankar: krizën ose siç quhet ndryshe “skandalin e LIBOR-it”. Dhe për më tepër, nuk bëhet fjalë për një ndodhi të çastit ose të rastit, por për një “devijim” të tij disavjeçar, 2005-2011. Thjesht i llogaritur gabim? ...manipulim i qëllimshëm? ..apo instrument i “vetëdijshëm”, për të maskuar krizën dhe vështirësitë e sektorit? Emri “LIBOR”, i njohur më së shumti në qarqet bankare dhe në tregjet financiare, u bë familjar në mbarë botën. Ky tregues i llogaritur dhe i publikuar çdo ditë në orën 11.30 në Londër nga Shoqata Britanike e Bankierëve, BBA, emri i të cilit formohet nga inicialet e London InterBank Offered Rate, shërben si normë reference në tregun monetar ndërbankar për monedhat kryesore të botës (dollarin amerikan, kanadez, neozelandez dhe australian, sterlinën angleze, jenin japonez, koronën daneze dhe suedezë, dhe euron).

LIBOR-i përdoret si bazë llogaritje për një numër të madh produktesh financiare globale si: çmimi i huave për pasuri të paluajtshme, huat e biznesit, ato studentore, kartat e kreditit, çmimet e tregjeve të lëndëve të para, transaksionet e de-


rivatëve të ndryshme financiare, etj. Në shkallë botërore, LIBOR-i shërben si referencë për çmimin e produkteve të ndryshme financiare, vlera e tregut të të cilave shkon të paktën në 350,000 miliardë dollarëve. Ai është barometri dhe busulla e tregut monetar botëror. Ndërkohë që normat bazë të interesit për bankat kryesore qendrore (FED, BQE, Banka e Anglisë, Banka e Japonisë, etj) jepen në bazë mujore, LIBOR-i është i përditshëm, duke u shndërruar kështu në termometrin ditor të financave botërore.

Ulja artificiale e vlerës së tij, sidomos në krahasim me vlerën e normës bazë të interesit të bankave qendrore u krijon mundësi bankave që t’i japin njëra-tjetrës hua me çmim të lirë, ndërkohë që huat për bizneset, për individët ose përgjithësisht për tregun financiar bankat i japin me vlerën reale të tij, pra me qëllim që të nxjerrin fitime të mëdha.

Të manipulosh LIBOR-in, ose dhe thjesht “të gabosh” me të, do të thotë që sistemin nervor të mekanizmit financiar e monetar botëror ta çorientosh në drejtime të rrezikshme

Të manipulosh LIBOR-in, ose dhe thjesht “të gabosh” me të, do të thotë ta çorientosh në drejtime të rrezikshme sistemin nervor të mekanizmit financiar e monetar botëror. Dyshime u hodhën edhe mbi manipulime të mundshme të TIBOR-it (Tokyo Interbank Offered Rate) dhe EURIBOR-it (Euro Interbank Offered Rate), por këto dyshime ishin shumë më të lehta për faktin se pësha e LIBOR-it në financat botërore është shumë më e madhe sesa ajo e TIBOR-it dhe EURIBOR-it, si dhe për faktin se paneli që fikson EURIBOR-in përbëhet (aktualisht) nga 44 banka, kundrejt 16 bankave (tashmë 18) që fiksojnë LIBOR-in; pra mundësia e manipulimit është shumë më e vështirë.

Dyshimet e para u shfaqën në fillim të vitit 2008, kur “makina që fabrikonte LIBOR-in”, BBA-ja deklaroi se “...dëshohet se disa nga anëtarët e saj kanë dhënë përqindje apo vlera të pasakta, duke rrezikuar të provokojnë një tronditje të madhe të tregjeve monetare”. BBA-ja e relativizoi njoftimin, duke nënvizuar kujdesin e saj për “të garantuar se LIBOR-i në dollarë do të ishte transparent, objektiv dhe i saktë... se luhatja jonormale e këtij treguesi lidhej vetëm me ecurinë e krizës financiare”. Por në mars të 2011-ës, çështja shpërtheu në Zvicër. Banka UBS njoftoi se kishte konstatuar manipulime të qëllimshme të LIBOR-it duke marrë dhe paralajmërimet nga autoritetet e mbikëqyrjes amerikane dhe japoneze. Po në të njëjtin muaj, gazeta “Financial Times” deklaronte se hetimi për këtë çështje nuk kufizohet vetëm tek UBS-ja, por dhe te



15 bankat e tjera: Bank of America, Barclays, Citigroup, Credit Suisse, Deutsche Bank, HSBC, JP Morgan Chase, Lloyds Banking Group, HBOS, Rabobank, Bank of Tokyo-Mitsubishi, Norinchukin Bank, RBS, WestLB; pra tek të gjitha bankat që përbënin panelin që përcaktonte vlerën e LIBOR-it. Siç u konstatua më vonë, rolin qendror në këtë çështje e kishte luajtur banka Barclays.

Në shkurt të vitit 2012, skandali i LIBOR-it mori përmasa globale. Autoritetet amerikane filluan hetime speciale ndaj Bank of America, ndërkohë që autoritetet mbikëqyrëse zvicerane (Camco) filluan kontrolltet në 12 banka që operonin në Zvicër. Hetimet u zgjeruan edhe në kontinentin aziatik. Në qershor të 2012-ës, dyshimet u shtuan edhe më shumë kur Barclays njoftoi se "kishte paguar 360 milionë euro për t'i dhënë fund hetimit që autoritetet britanike dhe amerikane të mbikëqyrjes po kryenin mbi përpjekjet e saj për manipulimin e LIBOR-it dhe EURIBOR-it, ndërkohë që zyra Britanike e Luftës Kundër Krimin Financiar (SFO) kishte hapur një padi penale ndaj kësaj banke, duke detyruar presidentin e saj, Bob Diamond, dhe zëvendës-presidentin, Jerry Misner, që të jepnin dorëheqjen. Hije dyshimi u hodhën dhe mbi Bankën e Anglisë, numri dy i së cilës, Paul Tucker, dyshohej se kishte nxitur Barclays që të "manovronte" me LIBOR-in duke e garantuar atë se Banka e Anglisë "do të mbyllte sytë" nëse Barclays publikonte një vlerë më të vogël se vlera reale për të dhe sidomos në momentet kur kriza financiare ishte në kulmin e saj.

Edhe Kongresi Amerikan kërkoi "auditimin" e sekretarit amerikan të thesarit, Timothy Geithner dhe të Presidentit të Rezervës Federale, Ben Bernanke, duke kërkuar shpjegime më të hollësishme për këtë "afërë". Gazeta "Washington Post" lajmëroi ekzistencën e disa email-eve të shkëmbyera midis Guvernatorit të Bankës së Anglisë, Mervyn King, dhe Sekretarit Amerikan të Thezarit, Timothy Geithner, ku flitej për një "reformë të domosdoshme dhe urgjente në procedurat e fiksimit të LIBOR-it". E përjavshme gjermane "Der Spiegel" njoftoi se Deutsche Bank i kër-

koi Komisionit European që të përfitonte statusin e "dëshmitarit të penduar" në këmbim të angazhimit të saj bashkëpunues në këtë hetim ndërkombëtar. Së fundi, gazeta "Financial Times" botoi njoftimin sipas të cilit mbikëqyrësit bankarë kishin gjetur lidhje ndërmjet disa tregtarëve të Barclays dhe katër bankave të rëndësishme europiane, duke nxjerrë në dritë edhe një personazh të çuditshëm, të quajtur Philippe Moryossef, një tregtar maroken që kishte punuar për bankën Societe Generale, përpara sesa të shkonte te Barclays. Ai kishte luajtur një rol kyç në manipulimin e "termometrit" të financave botërore dhe sipas një studimi të JPMorgan-it, pasojat e këtij skandali ishin më shumë se 12 miliardë dollarë.

Po pse bankat kanë "interes" që ta nënvlerësojnë madhësinë e LIBOR-it? Çfarë përfitojnë ato nga një veprim i tillë? Origjina e përgjigjes fillon që në vitin 2005. Konkurrenca ndërmjet bankave si dhe ndërmjet strukturave të ndryshme brenda tyre, fokusohet në nxjerrjen e përfitimeve nga zotërimi i "informacionit të privilegjuar" mbi ecurinë e mundshme të vlerës së LIBOR-it. Zotërimi ose manipulimi i këtij informacioni krijonte avantazhe të konsiderueshme. Me shpërthimin e krizës financiare, në fund të vitit 2007, gjithçka u përshpejtua. Bankat u përballën me sfidën e asfiksimit apo dhe të bllokimit të tregjeve ndërbankare, duke mos pasur mundësi që t'i huanin para njëra-tjetrës. Kështu u "justifikua" dhe Barclays përballë autoriteteve britanike të kontrollit financiar duke nënvizuar se "ajo kishte pasur frikë se mos përjashtohet nga tregu ndërbankar dhe kështu do të falimentonte, duke shkaktuar efekte zinxhir në të gjithë sistemin bankar ndërkombëtar".

Ndryshe nga përqindjet e interesit të tregut, që përcaktohen si efekt i kërkesës dhe i ofertës, përqindjet e interesit ndërmjet bankave reflektojnë kryesisht procedura bilaterale, duke qenë deklarative. Për t'i manipuluar ato mjafton që të "gënjeshtrohet" në momentin e deklarimit dypalësh. Por një bankë e vetme e ka shumë të vështirë ta bëjë një gjë të tillë, pasi për llogaritjen e LIBOR-it, Thomson Reuters eliminon nga mesatarja e deklarimit shifrat ekstreme më



të mëdha ose më minimale të vlerës së sugjeruar. Por nëse të gjitha bankat e panelit bien dakord, atëherë ato mund ta manipulojnë pa asnjë problem vlerën e tij, duke deklaruar të gjitha thujtë të njëjtën vlerë. Përfitimi nga ky manipulim është kolosal. Një ndryshim i qëllimshëm prej një ose dy për qind nga vlera reale shumëfishohet në dhjetëra e qindra milionë dollarë fitime. Sipas gazetës "Wall Street Journal", çdo vit indeksohen në vlerat e LIBOR-it dhe në vlerat e EURIBOR-it transaksione me vlerë mbi 600,000 miliardë dollarë, ose 10 herë më shumë se vlera e PBB-së botërore.

Për të munduruar sigurimin e

likuiditeteve dhe për të mos shqetësuar investuesit, bankat duhet të dëshmonin, të paktën në dukje, se ishin solide dhe nuk kishin probleme kërcënuese për aktivitetin dhe gjendjen e tyre. Nëse ato e deklarorin në shifrat reale LIBOR-in, shifra që për shkak të krizës ishin të larta, atëherë dhe përqindjet e interesit do të ishin të larta, duke dëshmuar kështu një nivel të lartë rreziku. Për pasojë, nëse në mënyrë kolektive bien dakord ta shpallim më të ulët vlerën e LIBOR-it, pra ta nënvlerësojmë atë, bankat e panelit të LIBOR-it përfitojnë duke penalizuar të gjitha bankat e tjera, që kanë nënshkruar kontrata financimi në dollarë për klientët e tyre, të indeksuara me të, por që i realizojnë kontratat e tyre mbi koston reale të këtij likuiditeti në dollarë, duke mos e rikuperuar dot diferencën ndërmjet vlerës reale dhe asaj të shpallur, që në fakt është nënvlerësuar. Ujta artificiale e vlerës së tij, sidomos në krahasim me vlerën e normës bazë të interesit të bankave qendrore i krijon mundësi bankave që t'i japin njëra-tjetrës hua me çmim të lirë, ndërkohë që huat për bizneset, për individët ose përgjithësisht për tregun financiar i japin me vlerën reale të tij, pra të nxjerrin fitime të mëdha.

Përmbledhtazi, logjika e veprimeve me LIBOR-in është: kur ekonomia ecën mirë, bankat kanë interes ta rrisin vlerën e tij dhe të EURIBOR-it për të dhënë hua me interesa më të larta dhe për të garantuar fitime më të mëdha; kur ekonomia shkon keq dhe bie në krizë duke prekur dhe sektorin bankar, nëse një bankë është dobësuar ajo ngjall dyshime për qëndrueshmërinë e saj dhe për pasojë i detyron bankat e tjera që të jenë të kujdesshme, duke i dhënë hua me nivele të larta interesi, të gjykuara si "hua me rrezik të lartë". Por nëse vlera e LIBOR-it ulët artificialisht kjo bankë ka mundësi që ta fshehtë gjendjen e saj të vërtetë financiare, duke vazhduar të marrë hua me norma të ulëta interesi, pra "pa rrezik". Pikërisht për këto lloj veprimesh u akuzua Barclays dhe bankat e tjera të panelit të LIBOR-it.

Për të eliminuar rrezikun e rishfaqjes së krizave të tilla me LIBOR-in, ose me EURIBOR-in në të ardhmen, sidomos për të kufizuar rrezikun e

konflikteve të interesit dhe abuzimit me pozicionet dominuese në sektorin financiar dhe veçanërisht "përcaktimin e trukuar të përqindjes së huas ndërbankare", ekspertët e rregullimeve financiare sugjerojnë zbatimin e disa reformave të rëndësishme strukturore. Në krye të tyre, përveç masave legislative e rregulluese me karakter kombëtar, është miratimi i një ligji kuadër evropian ose ndërkombëtar, i frymëzuar nga

Për të eliminuar rrezikun e rishfaqjes së krizave të tilla me LIBOR-in ose me EURIBOR-in në të ardhmen, ... sugjerohet që përveç masave legislative dhe rregulluese me karakter kombëtar, të miratohet një ligj kuadër evropian ose ndërkombëtar, që lejon kufizimin e shumë rreziqeve dhe abuzimeve, sidomos për luftimin e fenomeneve oligopolistike në sektorin bankar dhe ndarjen e funksioneve të bankave depozituese nga ato të investimeve.

ligji "Glass-Steagall", i vitit 1933 në SHBA, i cili lejon kufizimin e shumë rreziqeve dhe abuzimeve, sidomos për luftimin e fenomeneve oligopolistike në sektorin bankar dhe për ndarjen e funksioneve të bankave depozituese nga ato të investimeve.

Në dhjetor të vitit 2009, senatorët amerikanë, John McCain dhe Maria Cantwell, si dhe ish-guvernatori i FED-it, Paul Volcker, hodhën idenë e një rikthimi të ligjit Glass-Steagall, ndërkohë që edhe në Europë shumë ekspertë kërkojnë zbatimin e një legjislatiioni bankar strikt të frymëzuar nga ky ligj. "Liborgate" bëri që gjatë vitit 2012, gazeta "Financial Times" të shkruante disa herë për nevojën e një "Glass-Steagall II evropian", në thelb të të cilit qëndronte një ndarje e qartë ndërmjet bankave të investimeve dhe bankave të kursimeve, apo depozitave.

Kartë Krediti MasterCard

Përfito nga lehtësitë
dhe **siguria** e kartës së kreditit
MasterCard të **Union Bank**



ASNJË KOMISION

Për **blerje** mallrash dhe shërbimesh
brenda dhe jashtë vendit

PA PAGESË

Kontrolloni veprimet tuaja dhe shlyeni
detyrimin nëpërmjet faqes së internetit

APLIKONI ONLINE

 **UNIONBANK**
Banka që dua

☎ 04 238 9111

www.unionbank.al

BKT NXJERR PRODUKTE TË REJA NË MBËSHETJE TË BUJQËSISË

Banka Kombëtare Tregtare (BKT), në kuadër të nismës për të mbështetur bujqësinë, ka nxjerrë në treg një produkt të ri kredie për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që operojnë në fushën e bujqësisë, Kredinë BKT AGRO.

Në aktivitetin e zhvilluar në kuadrin e Panairit të Agrobiznesit dhe Turizmit, me sponsor kryesor BKT-në, drejtori i përgjithshëm dhe anëtari i Bordit Drejtues të BKT-së, z. Seyhan Pencabligil, theksoi rëndësinë jetike që ka zhvillimi bujqësor për vendin. Sipas tij zhvillimi i bujqësisë e kthen atë në një vend që duhet të prodhojë aq sa i nevojitet për të plotësuar mjaftueshëm nevojat e popullsisë me produkte bujqësore. Detyrën për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, sektor tejet i rëndësishëm për vendin, e theksoi në fjalën e tij edhe drejtori i Grupit të Bankingut Tregtar, z. Pekhan Isipek. Për këtë arsye BKT-ja ka dhënë dhe vazhdon të japë ndihmesën e saj në zhvillimin e sektorit bujqësor; ajo ua lejon operatorëve të ndryshëm të këtij sektori aksesin



USAID-I NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME BANKAT SHQIPTARE PËR TË NXITUR HUAT BUJQËSORE

Nëpërmjet Autoritetit të Kredisë për Zhvillim (Development Credit Authority - DCA), USAID-i po shton mundësitë e kredimarrjes për sektorin e bujqësisë dhe për agrobizneset në Shqipëri. Përmes marrëveshjes për kredi bujqësore, në shumën 15 milionë US\$, ndërmjet USAID-it dhe dy bankave vendase, ProCredit dhe Banka Kombëtare Tregtare (BKT), fermerë shqiptarë, ndërmarrje të vogla dhe të mesme bujqësore (SME) do të mund të marrin kredi më me lehtësi.



Faktikisht, vetëm rreth 2% e huave private shkon në sektorin e bujqësisë. Përmes programit DCA do të jepen kredi për ndërmarrjet bujqësore, që merren me prodhimin e produkteve të qumështit, të frutave dhe perimeve të freskëta e të përpunuara, përfshirë ullirin dhe bimët mjekësore si dhe erëzat, me qëllim që të mbështeten investimet në teknologjitë e reja: paketimin dhe marketingun. Kjo marrëveshje u modelua sipas një programi të ngjashëm, të iniciuar nga USAID-i në Kosovë, në vitin 2007, program që ka rritur së tepërmi kreditimin e huamarrësve bujqësorë në Kosovë.

në kapital, një sfidë kjo që deri më sot ka penguar zhvillimin e bujqësisë dhe investimet në këtë fushë. Kredia BKT AGRO, e sapoprezantuar nga BKT-ja, është e ndarë në tri segmente: Agro Kredi Speciale, Agro Kredi Suport dhe Agro Kredi. Së fundmi, BKT-ja ka finalizuar një marrëveshje me USAID-in për financimin e bujqësisë deri në shumën prej 15 milionë eurosh.

PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE

■ CREDINS BANK

Mbështetje për mjediset e gjelbra



Përgjegjësia sociale mbetet një nga prioritetet e Credins Bank duke qëndruar aktive në vazhdimësi dhe duke ofruar shembullin e ndërgjegjësimit të biznesit në shërbim të një jete sa më të qytetëruar. Gjatë kësaj periudhe përmendet krijimi i hapësirës së gjelbëruar në mjediset e Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi" si dhe mbjellja e pemëve dekorative në një nga rrugët kryesore të Bashkisë Kamëz.

Këto nisma janë mirëpritur nga komunitetet përkatëse, duke treguar se vetëm duke ngritur në nivel të lartë përgjegjësinë sociale dhe frymën filantropike, biznesi kthehet në shërbim të komunitetit edhe në aspektin human.

■ FIRST INVESTMENT BANK



Sponsor kryesor i Ansamblit Kombëtar Folklorik "Bëllgare" në shfaqjen "Kjo është Bullgaria"

Ansambli më i madh privat profesionist i folklorit në Evropë - "Bëllgare", dha spektaklin "Kjo është Bullgaria", në Tiranë, në kuadrin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në Teatrin e Operës dhe Baletit, më 13 Shtator duke zbuluar në mënyre unike për publikun pasurinë dhe bukurinë e muzikës, këngëve dhe valleve folklorike nga rajone të ndryshme të Bullgarisë.

Fibank ishte sponsori kryesor i këtij spektakli, me dëshirën për të mbështetur edhe shkëmbimin e komunikimin kulturor mes dy vendeve. Kulminacioni i këtij spektakli ishte edhe binjakëzimi i dy ansambleve kombëtare, atij Bullgar dhe Shqiptar.

Fibank si sponsor i projektit "Punësimi Sezonal i Studentëve", në Korçë

Është kthyer në traditë bashkëpunimi i Fibank me Bashkinë e qytetit të Korçës për projektin "Punësimi Sezonal i Studentëve". Ceremonia e mbylljes së këtij projekti dhe certifikimit të studentëve pjesëmarrës u organizua në mjediset e Life Gallery në qytetin e Korçës. Gjatë kësaj ceremonie, në të cilën morën pjesë Kryetari i Bashkisë, punonjës të Bashkisë, Drejtori Ekzekutiv i Fibank, punonjës të Fibank dhe rreth 60 studentë të përfshirë në këtë projekt u shpërndanë certifikata për të gjithë studentët të lëshuara nga të dy këta institucione.



■ INTESA SANPAOLO BANK

Një paradite në "Rreze drite"

Drejtoresha e Biznesit të Intesa Sanpaolo Bank Albania u ftua për të dhënë një orë të shkurtër mësimi pranë klasës së katërt fillore në shkollën 9 vjeçare jo publike «Rreze Drite». Ishte një orë shumë e këndshme ndërvepruese ku nxënësve iu dhanë disa njohuri të thjeshta bazë mbi bankën si institucion, produktet dhe shërbimet që ajo ofron si dhe ndikimin e saj në përditshmërinë tonë. Pasi u trajtuan disa shembuj të jetës së përditshme për mënyrat e kursimit dhe shpenzimit të parasë dhe rëndësisë së saj në shoqëri, fëmijëve iu shpërndanë dhe disa libra për moshën e tyre, të botuara së fundmi, me njohuri praktike mbi bankën.



■ RAIFFEISEN BANK

Kampet verore të "Terre des Hommes in Albania", për fëmijët e shtresave të pambrojtura

Raiffeisen Bank - Shqipëri vijoi për të dytin vit radhazi mbështetjen për kampet verore, të organizuar nga "Terre des Hommes in Albania", në Korçë, Durrës, Gjirokastrë, Sarandë, Vlorë etj. Këtë vit, tregues i suksesit të kampeve verore ishte jo vetëm nga numri në rritje i fëmijëve pjesëmarrës, por dhe fakti që pjesa dërrmuese e tyre vinin nga familjet e pambrojtura dhe të marginalizuara, nga të gjitha krahinat. Qëllimi ishte krijimi i një mjedisi të sigurt dhe edukativ, ku fëmijët mund të luajnë e të argëtohen e njëkohësisht të mund të nxiten krijimi i një atmosfere ku fëmijët të mund të zhvillojnë aftësitë e tyre sociale dhe emocionale, duke u dhënë kështu mundësi atyre të shprehin ndjenjat e tyre si dhe të përballen me realitetin. Në këto kampe verore morën pjesë rreth 900 fëmijë. Politika e sponsorizimeve të Raiffeisen Bank është përqendruar gjithnjë në projektet në ndihmë të komunitetit. Nëpërmjet këtij projekti, Raiffeisen Bank demonstroi përsëri se mbetet një bankë e komunitetit, për komunitetin.



■ TIRANA BANK

“Nisma e gjelbër” për Komunën Qendër Bilisht

Në vijim të projekteve për shtimin e mjediseve të gjelbra, Tirana Bank në bashkëpunim me Komunën Qendër Bilisht, ka zhvilluar projektin për mbjelljen e pemëve dekorative përgjatë rrugës kryesore të komunës. Nisma “e gjelbër” u nxit nga vetë punonjësit e Degës së Bilishtit për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mjedisit në këtë zonë. Pema e gjelbër e Tirana Bank, simboli i këtyre projekteve, u vendos përgjatë rrugës ku janë mbjellë këto pemë.



Vijon projekti i “dixhitalizimit të orëve të mësimit”

Pas Korçës, Pogradeci ishte stacioni i radhës për sa i përket mbështetjes së projekteve për “dixhitalizimin e orëve të mësimit”. Në këtë kuadër, Tirana Bank sponsorizoi blerjen e një table ndërvepruese dixhitale (Smart Board), e cila do të mundësojë modernizimin e metodave të mësimdhënies në Drejtorinë Arsimore të Pogradecit.

■ VENETO BANKA



Veneto Banka në mbështetje të promovimit të vlerave artistike në Shqipëri

Veneto Banka sponsorizoi së bashku me Universitetin “Marin Barleti” ekspozitën e piktorit dhe fotografit vlonjat Fate Velaj. Kjo ekspozitë, e cila vazhdon të jetë e hapur për artdashësit fierakë, vjen në vazhden e aktiviteteve “Europa Plaza” nën kujdesin e Bashkisë Fier, që po organizon artisti Fate Velaj, pas kurorëzimit me sukses të një projekti të njëjtë në qytetin e Pogradecit, pak kohë më parë. Veneto Banka po vazhdon të mbështesë shumë artistë të tjerë në aktivitetet e tyre për promovimin e vlerave artistike në Shqipëri.

■ UNION BANK

Union Bank vijon mbështetjen për Kombëtaren Shqiptare të futbollit

Union Bank, në vijim të mbështetjes së skuadrës së Kombëtares Shqiptare për sezonin e mëparshëm 2010-2012, ka rinovuar marrëveshjen e bashkëpunimit me Federatën Shqiptare të Futbollit dhe do të mbështesë Kombëtaren Shqiptare edhe për periudhën 2012 - 2014, gjatë pjesëmarrjes në ndeshjet kualifikuese të “Kupa e Botës - Brazil 2014”.

Për Union Bank dhe drejtimin ekzekutiv të saj, rinovimi i marrëveshjes me FSHF-në për mbështetjen e Kombëtares së Futbollit vjen natyrshëm, sepse duke mbështetur Kombëtaren, Union Bank si bankë me kapital shqiptar, vazhdon të mbështesë ato vlera të cilave u referohen shqiptarët kudo ku ata janë.



LAJME NDËRBALLKANIKE

BOSNJE - HERCEGOVINË

**BERZH mbështet Bosnjën me 10 milion euro për kreditimin e SME-ve***BERZH - 31 gusht 2012*

Në një klimë ekonomike sfiduese, ku sasia e financimeve bizneset e vogla në Bosnje është e kufizuar, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim do të vazhdojë të mbështesë ekonominë reale të vendit, me një linjë kredie prej 10 milionë eurosh për bankën Intesa Sanpaolo, me qëllim pikërisht kreditimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME). Huaja e BERZH do të ndihmojë bankën Intesa Sanpaolo t'i përgjigjet kërkesës nga ndërmarrjet e sektorit privat për financime, në kushtet e krizës ekonomike. "Ne presim që ky projekt të ketë një ndikim të menjëhershëm në disponueshmërinë e kredisë në treg," tha Libor Krkoska, drejtor i Zyrës së BERZH në Sarajevë. Që nga fillimi i operacioneve në Bosnje, BERZH ka disburuar 1.4 miliardë euro, në mbi 100 projekte në sektorët kyç të ekonomisë.

Bosnje, huatë rriten më shpejt se depozitat*BNE - 12 shtator 2012*

Në fund të muajit korrik, portofoli i huave të bankave tregtare boshnjake u rrit, me bazë vjetore, më shpejt se totali i depozitave. Institucionet huadhënëse boshnjake e zgjeruan huadhënien me 15.73 miliardë marka boshnjake (8 miliardë euro), me një rritje vjetore 4.3% dhe me një rritje mujore 0.34%. Për të njëjtën periudhë, totali i depozitave preku vlerën e 12.967 miliardë marka boshnjake, me një rritje vjetore 2.23% dhe me një rritje 0.02% krahasuar me muajin paraardhës. Të dhënat nga Banka Qendrore treguan se ritmi i rritjes u ngadalësua në të dy segmentet, krahasuar me fundin e qershorit. Në fund të qershorit, rritja vjetore e portofolit të huave ishte 4.5%, ndërsa vëllimi i depozitave ishte rritur me 3.3%.



BULLGARIA

**Bullgari, depozitat bankare rriten 6% me bazë vjetore***BNE - 4 shtator 2012*

Depozitat bankare në Bullgari u rritën në korrik me 6% me bazë vjetore dhe arritën vlerën e 61.5 miliardë levave bullgare (31.4 miliardë euro). Sipas të dhënave nga Banka Qendrore, vlera e depozitave është sa 93% e portofolit bruto të huave, çka tregon nivele të larta likuiditeti. Norma e rritjes vjetore së depozitave ra lehtë nga vlera prej 6.3% e muajit qershor. Depozitat e individëve vazhduan rritjen me ritme të larta, duke u shtuar me 14.9% në muajin korrik dhe duke mbuluar 51.7% të totalit të huave, çka shënon përqindjen më të lartë që nga janari i vitit 2008.

S&P rrit vlerësimin për borxhin afatshkurtër të Unicredit Bulbank*BNE - 4 shtator 2012*

Standard & Poor's bëri të ditur se ka rritur vlerësimin e kreditit afatshkurtër të bankës Unicredit Bulbank nga

A-3 në A-2, si rrjedhojë e rritjes së fundit të vlerësimit për borxhin sovran të vendit. Agjencia e vlerësimit mbajti të pandryshuar vlerësimin për borxhin afatgjatë të bankës, në nivelin BBB me perspektivë të qëndrueshme. Në muajin gusht, S&P rriti vlerësimin e borxhit sovran afatshkurtër në monedhë vendase dhe në valutë të huaj të Bullgarisë, nga A-3 në A-2. S&P ka konfirmuar vlerësimin BBB, me perspektivë të qëndrueshme, për borxhin afatgjatë në monedhë vendase dhe të huaj.

KOSOVA



Bankierët turq interesohen për Kosovën

BQK - 7 gusht 2012

Një delegacion i bankierëve nga Turqia vizituan gjatë muajit gusht Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Bankierët turq u pritën nga Guvernatori Gani Gërguri dhe bashkëpunëtorët e tij, të cilët i njohën ata me profilin e sistemit bankar dhe ekonomik të Kosovës dhe mundësitë për të investuar në të. Guvernatori Gërguri ka nënvizuar përparësitë e sistemit bankar dhe atij ekonomik të Kosovës, si bazë e fortë mbështetjeje për investime të huaja. Në veçanti, në rrafshin makroekonomik është nënvizuar stabiliteti financiar dhe disiplina fiskale në vend, e reflektuar edhe me normën më të lartë të rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto në rajon. Ndërsa në rrafshin e sistemit bankar, është nënvizuar shkalla e lartë e kapitalizimit të tij, likuiditeti i kënaqshëm dhe niveli njëshifror i kredive me probleme.

Misioni i programit për vlerësimin e sektorit financiar viziton Kosovën

BQK - 19 shtator 2012

Misioni i përbashkët për Programin e Vlerësimit të sektorit Financiar të Kosovës ka vizituar vendin mes datave 18 shtator dhe 2 tetor. I nisur për herë të parë në vitin 1999, Programi i Vlerësimit të Sektorit Financiar është përgjegjësi e përbashkët e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore dhe paraqet një analizë të thellë dhe gjithëpërfshirëse të sektorit financiar të një vendi. Krahas ekzaminimit të stabilitetit të sektorit financiar, ky vlerësim fokusohet edhe në aspektet zhvillimore të këtij sektori, duke marrë parasysh gjithmonë specifikat individuale të secilit vend.

KROCIA



IFC shqyrton një hua prej 50 mln euro për Societe Generale Splitska Banka

IFC - 7 shtator 2012

Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) bëri të ditur se po shqyrton lëvrimin e një huaje prej 50 milionë eurosh për bankën Societe Generale – Splitska Banka. Në një njoftim zyrtar të IFC, thuhet se këto para' do të përdoren për financimin e korporatave dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që zhvillojnë aktivitetet në sektorin e bujqësisë. Pritet që dhënia e huas të diskutohet nga Bordi Drejtues i IFC-së gjatë muajit tetor.

Rezerva valutore rritet sërish në gjysmën e parë të vitit

Dalje - 13 shtator 2012

Në takimin e radhës të mbajtur në mesin e muajit Shtator, Banka Qendrore e Kroacisë bëri të ditur se rezerva valutore e vendit u rrit përsëri në gjysmën e parë të këtij viti. Në fund të muajit qershor, rezerva valutore arriti në 11.6 miliardë euro, me një rritje prej 440 milionë eurosh që nga fundi i vitit të kaluar. Ndërsa rezerva valutore neto arriti në 10.4 miliardë euro, me një rritje prej 399 milionë eurosh që nga fundi i vitit 2011.

GREQIA



Depozitat bankare në Greqi u rritën me 2% në muajin Korrik

Ekathimerini - 29 gusht 2012

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore Europiane, depozitat në bankat greke shënuan një rritje me

2% në muajin korrik, duke përmbysur tendencën rënëse të muajve maj dhe qershor. Krijimi i një koalicioni qeverisës në mesin e muajit qershor bëri që depozitat në muajin korrik të rriteshin me 3.2 miliardë euro dhe të arrinin vlerën e 159.4 miliardë eurove. Rrjedhja totale e depozitave nga bankat greke që nga korriku i vitit 2010 arrin në 58 miliardë euro, ndërsa që nga viti 2009 depozitat kanë rënë me 80 miliardë euro, ose rreth një e treta e depozitave që bankat zotëronin në atë kohë.

Banka e Pireut dhe Societe Generale pranë marrëveshjes për shitjen e Geniki Bank

Ekathimerini - 5 shtator 2012

Marrëveshja mes grupit Francez Societe Generale dhe Bankës së Pireut për shitjen e Bankës Geniki pritet të kompletohet së shpejti. Gazeta greke "Ekathimerini" bëri të ditur gjithashtu se sektori bankar po i paraprin një vendimi nga grupi tjetër francez, Credit Agricole, për të shitur filialin e saj grek, Emporiki Bank, çka pritet të bëhet e ditur së shpejti. Burime anonime u shprehën për gazetën se bisedimet mes Societe Generale dhe Bankës së Pireut janë në një fazë të avancuar dhe arritja e marrëveshjes është vetëm një çështje kohe. Banka Geniki zotëron aktive në vlerën e 2.9 miliardë eurove, hua në vlerën e 2.4 miliardë eurove dhe depozita në vlerën e 1.9 miliardë eurove, çka e bën një aktor domethënës në tregun lokal bankar.

MALI I ZI



Kapitali i bankave malazeze bie me 9.65%

BNE - 13 shtator 2012

Sipas të dhënave nga Banka Qendrore e vendit, kapitali i bankave të Malit të Zi ra me 9.65% me bazë vjetore, në fund të korrikut dhe preku vlerën e 275.8 milionë eurove. Megjithatë, banka qendrore nuk bëri të ditur se cilat nga 11 bankat e vendit mund të kenë nevojë për rritje kapitali. Shkaku kryesor i rënies së kapitalit janë rezultatet negative financiare të arritur nga disa bankave në periudhën janar-korrik të këtij viti. Humbjet kanë ardhur kryesisht nga rritja e provigjioneve për humbjet e mundshme nga kreditë me probleme. Banka Qendrore bëri të ditur se, me gjithë rritjen e konsiderueshme të depozitave, aktiveve dhe të likuiditeti në tërësi gjatë muajit korrik, kapitali aksioner dhe kreditimi janë në rënie. Kjo sjell shqetësime

për mjaftueshmërinë e kapitalit të bankave dhe mund të çojë në nevojën për shtesa kapitali.

Mali i Zi përfiton 50 mln euro nga BEI për mbështetjen e SME-ve

Balkans.com - 14 shtator 2012

Kabineti qeveritar i Malit të Zi miratoi marrëveshjen e huas mes Fondit të Investimeve dhe Zhvillimit të Malit të Zi dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) me vlerë 50 milionë euro. Ministri i Financave, Milorad Katnić, tha se qëllimi i huas është mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe zhvillimi i projekteve të infrastrukturës në Malin e Zi. Sipas tij, huaja do të ketë një maturim tetë vjeçar, me një periudhë faljeje dyvjeçare dhe një normë interesi nga 2.5% në 3.5%. Sipas ministrit Katnić, ky projekt do të kontribuojë në hapjen e vendeve të reja të punës dhe në zhvillimin ekonomik, veçanërisht në degët e bujqësisë, energjisë dhe turizmit.

MAQEDONIA



Banka Maqedonase për Nxitjen e Zhvillimit aprovon fondin për hua të buta

MIA - 23 gusht 2012

Banka Maqedonase për Nxitjen e Zhvillimit ka aprovuar fondin e parë prej 111 milionë eurosh në hua të buta. Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Financave, Zoran Stavreski, tha se deri tani janë paraqitura 80 aplikime për të përfituar nga një fond prej 100 milionë eurosh, i akorduar nga Banka Europiane të Investimeve (BEI). "Huaja prej 100 milionë eurosh e BEI është instrumenti kryesor për t'u përballur me krizën ekonomike dhe është pozitive që ky program po tërheq vëmendjen e biznesit. 20 milionë eurot e para janë lëvruar në fillim të shtatorit, ndërkohë që 80 sipërmarrje kanë aplikuar në program dhe do të përfitojnë fonde për të investuar në zhvillimin e biznesit të tyre," tha Stavreski.



RUMANIA



Kosto e provigjionimit të sistemin bankar rumun ra në 649 mln euro në tremujorit e dytë

BNE – 4 shtator 2012

Kosto e provigjionimit në sistemin bankar rumun ra në 2.1 miliardë lei, ose 469 milionë euro në tremujorin e dytë të këtij viti, sipas llogaritjeve të mbështetura në të dhënat e Bankës Qendrore të Rumanisë. Në tremujorin e parë, kosto e provigjionimit kishte qenë 722 milionë euro, vlera më e lartë që nga tremujori i dytë i vitit 2010 dhe e vlera e dytë më e lartë tremujore e të gjitha kohërave. Me gjithë rënien që vlera e provigjioneve shënoi në tremujorin e dytë të këtij viti, ajo është 12% më e lartë se vlera mesatare e katër tremujorëve të vitit 2011. Pavarësisht nga rënia e shpenzimeve për provigjione, bankat e mbyllën tremujorin e dytë të vitit me rezultat agregat financiar negativ. Në tremujorin e dytë, sistemi bankar shënoi humbje në vlerën e 73 milionë eurove, ndërkohë që tremujori i parë ishte mbyllur me fitim në vlerën e 29 milionë eurove. Përqindja e kredive me probleme në fund të tremujorit të dytë arriti në 26.1%, nga 21.9% që kishte qenë një vit më parë.

SERBIA




Banka Qendrore e Serbisë e mban normën e interesit në 10.5%

BNE – 7 shtator 2012

Me gjithë inflacionin në rritje, Banka Qendrore e Serbisë vendosi në mbledhjen e radhës së muajit shtator ta mbante normën bazë të interesit në 10.5%. Në muajin

korrik, inflacioni i çmimeve të konsumit arriti në 6.1% me bazë vjetore, duke u rritur për herë të parë që nga muaji Janar mbi intervalin 3.5%-5.5%, që është objektivi i Bankës Qendrore. Sipas IHS Global Insight, nuk priten ndryshime të shpejta të normës së interesit, veçanërisht pas sinjalit të fundit që dha Banka Qendrore. Përkundrazi, nëse qeveria e Serbisë do të miratojë një plan masash shtrënguese fiskale dhe nëse do të arrijë një marrëveshje të re kredie me Fondin Monetar Ndërkombëtar, parashikohet një ulje graduale e normës bazë të interesit duke filluar nga viti 2013.

TURQIA



Fitimi neto i sistemit bankar në Turqi rritet me 12.1%

BNE – 12 Shtator 2012

Fitimi neto i sistemit bankar turk arriti për shtatëmujorin e parë të këtij viti në 13.4 miliardë lira turke (5.8 miliardë euro), me një rritje prej 12.1% ndaj të njëjtës periudhë të një viti më parë. Totali i aktiveve u rrit me 5.5% krahasuar me fundin e vitit 2011 dhe arriti në 1.28 trilionë lira turke. Ndërsa portofoli i kredisë arriti në 742.8 miliardë lira turke, 8.8% më shumë se në fund të vitit të kaluar. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të korrikut ra lehtë në nivelin 16.3%, nga 16.5% që ishte një vit më parë. Kreu i Agjencisë së Rregullimit dhe Mbikëqyrjes së Bankave, Mukim Oztekin, parashikoi që fitimet e sistemit bankar këtë vit mund të arrijnë në 23 miliardë lira turke, nga 19.8 miliardë që ishin vitin e kaluar. Nga ana tjetër, Suleyman Aslan, drejtor i përgjithshëm i bankës me kapital shtetëror Halkbank, parashikon për këtë vit një rritje të portofolit të kredisë në intervalin 15%-20%.



•Kredi •Depozita •Biznes
•Transferta



KEMI FITUAR QETESINE ME



UBA

M-PAY, GATI PËR TË LANÇUAR PAGESAT PËRMES CELULARIT NË SHQIPËRI



nga Ludovic Laventure,
Drejtor Ekzekutiv, M-PAY

Ndërsa bota gëlon me gjithfarë platformash për pagesat përmes celularit, duke filluar nga shërbimi tradicional M-Pesa i Kenias e deri te zhvillimet e Perëndimit me pagesa ultrateknologjike pa kontakt fizik, Shqipëria ka mbetur disi prapa. Gjatë vitit 2011, pavarësisht mjedisit financiar botëror përgjithësisht të dobët, ky sektor vazhdoi të rritej, duke regjistruar të ardhura nga pagesat përmes celularit në 47.2 miliardë dollarë. Vërtet që shqiptarët mund të jenë ende disi të pamësuar me këtë lloj pagese, por prirja botërore po bëhet një realitet edhe në këtë vend të vogël të Ballkanit. Zhvillimet e fundit të tregut dhe evolucioni i pandërprerë në sektorin bankar, kërkesat gjithnjë në rritje të operatorëve celularë dhe të

M-PAY ofron edhe një tjetër karakteristikë të rëndësishme duke ofruar fleksibilitet të lartë teknologjik, çka bën që ky shërbim, me kosto të reduktuara dhe efikasitet të shtuar, të përshtatet me lehtësi në platformat ekzistuese

ofruesve të shërbimeve publike për efikasitet të shtuar në pagesa, nxjerrin nevojën për të zhvilluar platforma novatore, inteligjente, të sigurta dhe të volitshme.

I thjeshtë, inteligjent dhe i sigurt

Pagesat përmes celularit përfaqësojnë një hap të rëndësishëm në përparimet e sotme teknologjike, që ofrojnë përfitime në rritje, sa i takon sigurisë së shtuar dhe vëllimit të transaksioneve. Pagesat përmes celularit janë shumë më të sigurta krahasuar me alternativat ekzistuese të kartave plastike, pagesave përmes internetit, etj. Zakonisht, koha e nevojshme për t'u informuar mbi humbjen e një karte krediti/debiti është shumë më e madhe sesa koha mesatare për të kuptuar humbjen e telefonit celular. Në këtë mënyrë, koha e reagimit është më e shkurtër dhe instrumenti i pagesës në celular është më i sigurt.

Për sa i takon M-PAY, një institucion financiar jobankar, asnjë segment i platformës nuk është i lidhur me internetin publik, çka më vete do të thotë se segmentet e tjera janë private, B2B, të siguruar nga një sërë nivelesh sigurie duke përfshirë: tunele VPN, linja të dedikuara, enkriptime, nënshkrime digjitale etj. Procesi i pagesës është i bazuar në komunikim me bazë sesioni USSD. Menyja USSD do të mbrohet nga një PIN, i cili njihet vetëm nga konsumatori. Konsumatorët mund ta ndryshojnë me lehtësi PIN-in, mund të çaktivizojnë llogarinë e tyre përkohësisht ose përfundimisht, në rast të humbjes së celularit a të ndonjë dyshimi.

Ideja është vërtet e thjeshtë: Një platformë joekskluzive pagesash përmes celularit, e hapur ndaj të gjithë aktorëve që mirëpret të gjitha bankat, operatorët celularë dhe ofruesit e shërbimeve, në përfitim tërësor të konsumatorëve fundorë. Nuk nevojitet më prani fizike, radhë të gjata, humbje e panevojshme kohe dhe parash dhe as procedura të ndërlikuara. Gjithçka realizohet me pak veprime në një meny shumë të thje-

M-PAY përfaqëson një shërbim vërtet novator: ai lidh bankat, operatorët celularë dhe ofruesit e shërbimeve publike në një platformë të vetme, gjithëpërfshirëse. Përdoruesit mund të aksesojnë menynë USSD në telefonat e tyre në çdo kohë, të kontrollojnë për fatura të papaguara dhe të kryejnë pagesën me ndihmën e pak butonave.





shtë, të integruar në telefonin celular të klientit, mundësuar nga operatorët celularë. M-PAY nuk përdor aplikime të instaluar, ndaj dhe çdo pajisje celulare me GSM, nga celularët e zgjuar, nga më të përparuar deri te modelet më të vjetra të tyre, mund të funksionojnë krejtësisht me menynë USD. Ndërkaq, M-PAY është duke bashkëpunuar me Eagle Mobile dhe Vodafone Albania. Kjo zgjidhje është dizenuar dhe ndërtuar që të jetë në gjendje të lidhë në platformë të gjithë operatorët celularë, institucionet financiare, ofruesit e shërbimeve etj. Modulet e shumëfishta në këtë platformë e thjeshtësojnë këtë detyrë, duke qenë se ajo përmban module dhe ndërfaqe për të gjithë aktorët e mësipërm.

Në të njëjtin ekip me bankat

Bankat përfitojnë ndjeshëm nga zgjidhjet e pagesave përmes celularit. Prania fizike e klientëve në mjediset e tyre ulet ndjeshëm, krahas zvogëlimit të transaksioneve me para në dorë, në një kohë që këto zgjidhje mundësojnë një rritje të vëllimit të transaksioneve ndërmjet bankave, ofruesve të shërbimeve dhe operatorëve celularë.

Në rastin e Shqipërisë, një zhvillim i mëtejshëm i kanaleve të pagesës është vendimtar po të marrim parasysh kanalet elektronike jo dhe aq të zhvilluara. Sipas Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2011, rreth gjysma e popullsisë së vendit zotëron llogari bankare, por vetëm 28 për qind e shqiptarëve, që zotërojnë llogari bankare, domethënë më pak se 1/3 përdorin instrumente elektronike për të kryer pagesat e tyre. Përshatja e pagesave përmes celularit

do të rrisë transaksionet elektronike, teksa ofron më shumë efikasitet dhe përfitime. Ndërsa bankat kanë në thelb të biznesit të tyre operacione të tjera qendrore (si huadhënia dhe depozitat), ku shërbimet e reja dixhitale, që lehtësojnë transaksionet, kanë një peshë dytësore, biznesi qendror i shoqërive të pagesave me celular është zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i këtyre zgjidhjeve.

Është pikërisht vendosja e një fokusi parësor dhe vendimtar, ajo që mundëson shoqërinë e pagesave përmes celularit që të ofrojë një shërbim të pazëvendësueshëm për aktorët e tjerë me një tjetër fokus në biznes. Kështu, M-PAY ofron edhe një tjetër karakteristikë të rëndësishme duke ofruar fleksibilitet të lartë teknologjik, çka bën që ky shërbim të përshatet me lehtësi te platformat ekzistuese, me kosto të zvogëluara dhe me efikasitet të shtuar. Me platformën e tij të përgatitur në imtësi dhe pranë fillimit të operacioneve, M-PAY po bashkëpunon me Societe Generale Albania dhe Raiffeisen Bank. Duke qenë pjesë e këtij shërbimi, bankat mund të përfitojnë jo vetëm nga instalimi i një platforme funksionale dhe të sinkronizuar, por edhe nga përditësimet konstante me novacionet më të fundit teknologjike. Kjo qasje mundëson rritje të ndëroperabilitetit, komunikim më të mirë në tërësi dhe një rritje të vëllimit të transaksioneve.

M-PAY ndez motorin

Në këtë kontekst, M-PAY brenda muajve të ardhshëm do të nisë shërbimet e tij novatore në bashkëpunim me bankat, operatorët celularë, ofruesit e shërbimeve publike dhe me aktorë të tjerë kyç. Pas disa vitesh pune të madhe dhe këmbënguljeje, projekti është formësuar duke shtuar në mënyrë të qëndrueshme radhët e tij me partnerë, që besojnë te potenciali dhe te sukcesi i tij. M-PAY brendëson njëherësh shërbimin dhe misionin për të zhvilluar në Shqipëri një prej industrive me rritje më të shpejtë në botë.

Në realitetin e tregut, pagesa e faturave është një përvojë që harxhon kohë për konsumatorin dhe kjo është arsyeja pse M-PAY po paraqitet si

Efikasiteti që zgjidhjet e pagesave me celular ofrojnë për sektorin bankar janë në radhë të parë të lidhura me fokusin parësor të shoqërisë; të gjejë sa më shumë ofrues shërbimesh dhe të ndihmojë për një vëllim maksimal transaksionesh ndërmjet tyre.

mënyra më e mirë për të zhvilluar një platformë pagesash me celular, në dhe për Shqipërinë. Sigurisht, kur tregu të jetë familjar dhe të përqafojë këtë mënyrë pagese, M-PAY do të hapet dhe për tipologji të tjera ofruesish shërbimesh dhe shitësish dhe do të lehtësojë edhe më tej jetën e konsumatorit shqiptar.

Krahas shërbimeve kaq funksionale, platforma do të përfshijë shërbime dhe mundësi të reja për partnerët dhe konsumatorët, që do të materializohen në të ardhmen e afërt. Kjo është koha e duhur për të vepruar dhe për të përfituar nga mundësitë që presin për t'u rrokur. Siç dëshmon historia, përditësimet e përshtatura mëdyshtazi, në faza më të vona dhe me ritëm më të ngadaltë, janë të prirura të humbasin momentin e duhur dhe të rrisin shpenzimet.



KOMITETI I MENAXHIMIT TË AKTIV – PASIVEVE, ALCO, KOMITETI MË I RËNDËSISHËM BANKAR



nga Erjon TAÇE
Drejtor i Thesarit
SOCIETE GENERALE ALBANIA

Zbatimi i politikave/planeve të ALCO-s, ia mundëson bankës një strukturë optimale të bilancit, që e mbron atë nga rreziqet tradicionale, duke maksimizuar fitimin në periudhën afatmesme dhe afatgjatë

Nëse nuk do t'i kushtohej rëndësi analizës dhe parashikimit të situatës së likuiditetit të bankës, rritja e pakontrolluar e huadhënies dhe zgjerimi delikat i veprimtarisë së bankës mund të kenë pasoja serioze. Nga ana tjetër, nëse nuk i kushtohej rëndësi depërtimit në treg dhe zhvillimit të vetë produktit, analiza e likuiditetit, kur dominon dhe kur prezantohet si tepër e pafavorshme mund të kufizojë, madje edhe dëmtojë rritjen e bankës.

Është pranuar gjerësisht se opinioni i drejtuesve të linjave të biznesit të bankës duhet harmonizuar me atë të drejtuesit të strukturës së menaxhimit të aktiv – pasiveve (ALM) ose me drejtuesit e Rrezikut apo me drejtuesit e Thesarit. Gjithashtu, është pranuar që opinioni i drejtuesit të ALM-së, Rrezikut apo Thesarit nuk duhet të qëndrojë i vetëm në ato raste kur ndikon zhvillimin e ardhshëm të veprimtarisë së bankës. Të gjitha këto opinione pasi të trajtohen dhe të përpunohen duhet të diskutohet duke u mbështetur me argumente të vlefshme, me qëllim që të arrihet një konvergencë e parashikimit (ose e ndikimit). Paskëtaj, vendimet për

bankën bëhen efçente dhe efektive. Është pikërisht kjo arsyeja që bankat kanë krijuar dhe mbajnë Komitetin e Menaxhimit të Aktiv – Pasiveve. Quket Komitet pasi përmbledh këndvështrime dhe propozime të ndryshme.

Thelbi i ALCO-s në çdo bankë përqendrohet minimalisht te një qëllim: të sigurojë që banka të ketë në çdo kohë një përfitueshmëri optimale dhe një strukturë të bilancit që mundëson mbrojtjen e bankës nga goditjet e rreziqeve kryesore, që lidhen me likuiditetin, me normën e interesit dhe me kursin e këmbimit.

Një linjë biznesi nuk mund të ecë pa përafrimin e perspektivës së tij me kushtet e tregut dhe me zhvillimet e së ardhmes së afërt, të pranuar me konsensus nga anëtarët e ALCO-s. Në mënyrë të ngjashme, perspektivat e linjave të biznesit, për sa i përket zhvillimit të produkteve ose zgjerimit të aktivitetit, nuk duhet të pengohen nga një analizë përkohësisht hezituese e ALM-së.

Por cilat janë vendimet që merr ALCO dhe sa të rëndësishme janë ato?

Anëtarët e ALCO-s përfshijnë drejtues të lartë të bankës. Vendimet kanë të bëjnë me politika, me plane ose dhe me udhëzime mbi operacione të veçanta bankare. Normalisht, bankat ndryshojnë nga njëra-tjetra për nga madhësia, nga përqendrimi i veprimtarisë, ose dhe për nga lloji i tregut ku operojnë. Për shembull nga:

1. rreziku i likuiditetit/financimit
2. rreziku i normës së interesit
3. rreziku strukturor i kursit të këmbimit

Struktura e përsosur e bilancit nuk ekziston. Kjo vjen kryesisht për shkak të faktit se zhvillimet në strukturën e



SHIJONI ËMBËLSINË E DEPOZITAVE, TANI TË PERSONALIZUARA.

Dëgjojmë me vëmendje kursimet tuaja dhe ju japim kushtet më të mira. Shijoni ëmbëlsinë e depozitave tuaja me normat e interesit më të larta në treg. Ju mund t'i përfitoni ato kur të dëshironi pas 1, 3, 6 muajsh apo 1 viti. Ndaloni ne degën e Veneto Banka më afër jush dhe drejtohuni konsulentëve tanë për më shumë, ata ju mirëpresin.

Lekë deri në 7.5%

Euro deri në 4.3%

Dollar deri në 2%



bilancit janë shumë dinamike. Bankat pra, e mbajnë nën kontroll rrezikun por, gjithsesi, ato operojnë brenda një niveli të pranuar të tij. Në fund të fundit, kjo është një pjesë e pandashme e misionit të bankës. Më pas, i takon ALCO-s që të sigurojë se banka e mban veprimtarinë e saj brenda objektivave të këtyre rreziqeve.

Imagjinoni një situatë ku anëtarët e ALCO-s i kalojnë përciptazi raportet ose analizat e ALM-së apo të Rrezikut, të cilat tregojnë për një vështirësi në rritje të bankës për të operuar në tregjet ndërbankare ose financiare. Përfundimet mund të ishin katastrofale, madje dhe në një periudhë afatshkurtër. Prandaj, në fund të çdo mbledhjeje të ALCO-s, si një pjesë e domosdoshme e një aide-memoire (ndoshta edhe formale) për drejtuesit e lartë, duhet të ketë disa pyetje të cilat duhet të adresohen me përpikëmeri gjatë mbledhjeve, si më poshtë:

- A e kuptuan të gjithë anëtarët pozicionin kundrejt rrezikut (limitit)?

Biznesi i bankës nuk mund të ecë përpara pa një mbështetje të fortë nga analizat e ALM-së. Analizat e duhura dhe një diskutim konstruktiv në ALCO, janë vendimtare për një rritje të dëshiruar të huadhënies dhe të suksesit të produkteve të tjera.

- A janë të gjithë dakord për nivelin e rrezikut të financimit?
 - A janë të gjithë dakord për parashikimin e ndikimit?
 - A ka vullnet banka për parashikimin e rrezikut?
- Për t'u kthyer te përbërja e ALCO-s,

sërisht referencë mbeten praktikatat më të mira. Në këtë kontekst, praktikatat më të mira sugjerojnë që, prania e Drejtorit të Përgjithshëm (CEO) është e nevojshme në këtë Komitet, po kaq dhe vendimet e tij. Duke ballafaquar linjat e biznesit me rreziqet dhe me analizat e bëra, duhet të vendoset një ekuilibër i caktuar, në mënyrë që banka të vendosë qartazi mbi objektivat dhe mbi vullnetin për të marrë përsipër rrezik, por dhe shpërndarjen e burimeve.

Biznesi i bankës nuk mund të ecë përpara pa një mbështetje të fortë tek analizat e ALM-së. Analizat e duhura dhe një diskutim konstruktiv në ALCO janë vendimtare për një rritje të dëshiruar të huadhënies dhe të suksesit të produkteve të tjera. Ajo çfarë ALCO vendos, pasqyrohet drejtpërdrejt në rutinën e veprimtarisë së bankës. Duke zbatuar politikat/planet e ALCO-s, banka krijon një strukturë optimale të bilancit, që e mbron bankën nga rreziqet tradicionale, duke maksimizuar fitimin në periudhën afatmesme dhe në atë afatgjatë.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE PËR ZHVILLIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

TRAJNIME KORRIK - SHTATOR 2012

Trajnim mbi Auditimin, Zbulimin dhe Parandalimin e Mashtrimit të Brendshëm në Banka, 5-7 shtator 2012

AAB organizoi në bashkëpunim me Misionin USAID Tiranë dhe Assist Impact një kurs trajnimi mbi Auditimin, Zbulimin dhe Parandalimin e Mashtrimit të Brendshëm në Banka. Trajnimi u ndoq nga 32 specialistë të departamenteve të Auditit të Brendshëm të 15 bankave anëtare dhe u drejtua nga z. W. Valen McDaniel. Objektivi i trajnimit ishte identifikimi i rasteve të mashtrimit të brendshëm në kreditim si dhe i mangësive në kontrollin e brendshëm të procedurave dhe çështjeve organizative.



Workshop për “Ndërgjegjësimin mbi sigurinë në banka”, 17- 18 shtator 2012

Në workshopin me temë “ Ndërgjegjësimi mbi sigurinë në banka” që AAB organizoi në bashkëpunim me GLOBAL Community Security Group- Shqipëri, morën pjesë 12 drejtues dhe punonjës të sigurisë fizike të 10 bankave anëtare dhe një përfaqësues i departamenti të Sigurisë Fizike në Bankën e Shqipërisë. Objektivi kryesor i këtij kursi ishte rritja e ndërgjegjësit ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve, me të cilat përballlet sektori bankar në Shqipëri.

Trajnim mbi “Administrimin e Rrezikut Operacional”, 10 - 11 shtator 2012

AAB organizoi në bashkëpunim me IFC-në një kurs trajnimi dy ditor me temë “Administrimi i riskut operacional” të drejtuar nga dr.Yevgen Prokopenko dhe z. Denis Bondarenko. Kursi u ndoq nga 14 drejtues dhe specialistë të Riskut Operacional të 11 bankave anëtare dhe ishte projektuar në formën e një trajnimi praktik dhe ndërveprues mbi çështjet dhe sfidat e menaxhimit të riskut operacional. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit analizuan raste studimore dhe zhvilluan diskutime në grup.



Trajnim mbi “Praktikat më të mira të drejtimit”, 18-19 shtator 2012

AAB bashkëpunoi sërish me Shoqatën e Bankave për Europën Qendrore dhe Lindore (BACEE) për organizimin e trajnimit 2 -ditor me temë “Praktikat më të mira të drejtimit”. Trajnimi u drejtua nga Paul Gauci, trajnues e lektor profesionist i miratuar, dhe pati për qëllim nxitjen e pjesëmarrësve dhe zhvillimin e aftësive të tyre drejtuese, komunikuese dhe motivuese. Në trajnim morën pjesë 13 menaxherë dhe supëvizorë të 10 bankave anëtare.

Trajnim mbi "Kuadrin ligjor për sektorin bankar dhe financiar në Shqipëri dhe BE, 24-25 shtator 2012

AAB në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe AEDBF- Albania organizoi një kurs trajnim 2- ditor mbi "Kuadrin ligjor për sektorin bankar dhe financiar në Shqipëri dhe BE". Kursi adresoi çështje të infrastrukturës institucionale dhe ligjore, për të mbështetur tregun e sistemeve financiare dhe ndoq nga 13 juristë, përfaqësues të 7 bankave anëtare, nga 3 përfaqësues të departamentit Ligjor të Bankës së Shqipërisë si dhe nga këshilltarja ligjore e AAB.



Trajnim mbi "Standardet Financiare Ndërkombëtare të Raportimit" (IFRS)-Nivel i avancuar , bankë dhe financë, 25-26 shtator

AAB në bashkëpunim me KPMG Albania organizoi një trajnim mbi "Standardet Financiare Ndërkombëtare të Raportimit (IFRS) - Nivel i avancuar". Trajnimi i ndoqën pjesëmarrës nga departamentet e Financës të 5 bankave anëtare. Temat e trajtuara u përqendruan në prezantimin e standardeve më të reja dhe në zbatimin praktik të tyre. Trajnues në këtë kurs ishin përfaqësues të KPMG Sofia.

ARRITJA E SUKSESIT PËRMES VETËMOTIVIMIT

Vetëmotivimi nuk është thjesht i rëndësishëm;
ai është thelbësor për mbijetesën tonë

nga Paul Gauci¹

Thuhet se i gjithë motivimi është vetëmotivim. Është e vërtetë që familja, eprori ose bashkëpunëtorët mund të na ndihmojnë të ecim përpara në rrugën tonë, por nëse ne vetë nuk vendosim të ecim përpara, thjesht nuk do të ndodhë asgjë. Aftësia për të disiplinuar veten drejt përcaktimit të qëllimeve të qarta, por dhe për të punuar çdo ditë për përmbushjen e këtyre qëllimeve, do të garantonte më shumë suksesin tonë, sesa çdo faktor tjetër në veçanti.

Vetëmotivimi, nëpërmjet zhvillimit të pikës së brendshme të kontrollit, luan një rol kritik në drejtim të ndodhjes së ngjarjeve. Kjo nënkupton prirjen, që kanë individët, për t'ia atribuar ndodhjen e ngjarjeve ose veprimet e tyre ekzistencës së pikës së "brendshme" të kontrollit (domethënë, ia njohin vetes meritat për suksesin, por dhe fajin për dështimet) apo forcave (shkaqeve) të jashtme (fati, rastësia, etj) – e njohur si pika e

"jashtme" e kontrollit.

Thuhet se ekzistojnë tre lloj njerëzish:

(1) ata që bëjnë ngjarjet të ndodhin,
(2) ata që i shohin ngjarjet të ndodhin
(3) ata që habiten nga ato që ndodhin. Njerëzit me pikë të brendshme kontrolli i bëjnë ngjarjet të ndodhin dhe i përqendrojnë energjitë e tyre në përmbushjen e gjërave dhe qëllimeve... nëpërmjet "shfrytëzimit të rastit".

Shfrytëzimi i rastit nënkupton ruajtjen e kontrollit të jetës në çdo moment dhe çdo ditë. Që të mund t'i bësh ngjarjet të ndodhin duhet të kesh ... Qëllim, Dëshirë dhe Angazhim. Nuk ka rëndësi se nga vjen; ajo që ka shumë rëndësi është se ku do të shkosh. Vetëmotivimi gjen zbatim në marrëdhënien që ne kemi me vetveten, e për këtë qëllim, duhet të zotërojmë një inventar teknikash dhe "stilesh manovrimi" që mund t'i përdorim për të dalë nga situata për hir të së ardhmes sonë.

Vetëmotivimi nuk është thjesht i rëndësishëm; ai është thelbësor për

mbijetesën tonë. Ka shumë rëndësi që nga të tjerët të shihesh si person që dëshiron të realizosh diçka, të provosh gjëra të reja, të kesh kurajë të marrësh përsipër rreziqe, të sfidosh *status quo-në*, dhe të shkëlqesh. Mbi të gjitha duhet të jesh i sprovuar në vendosjen dhe përmbushjen e qëllimeve. Kur shoqëritë dhe individët dështojnë në arritjen e objektivave shpesh kjo vjen sepse ata nuk janë të frymëzuar aq sa duhet për të arritur qëllimet e tyre.

Kur qëllimet janë të paarrtshme ato nuk të japin më forcë dhe frymëzim, prandaj brenda vetes duhet të bëhet seleksionimi i tyre, por gjithnjë duke i dhënë përparësi objektivave të arritshëm. Për sa kohë që kemi një qëllim, edhe kur kemi vështirësi do të dimë të ecim përpara. E kur ta bëjmë këtë do të jemi më pranë qëllimit tonë. Një proverb japonez thotë: *Nuk është turp të rrëzohesh, por turp është të mos arrish të ngrihesh përsëri.*

¹ Paul Gauci B.A.(Hons); M.Ed (Trg & Dopt) Sheffield; Anëtar i miratuar i MCIPD-së (Member of the Chartered Institute of Personnel and Development) dhe trajnues e lektor profesionist, me përvojë trajnimi 25- vjeçare në banka në rrafsh ndërkombëtar. Ai ka udhëhequr 2 kurse trajnimi të organizuara nga AAB në Tiranë: "Kujdesi për klientin dhe aftësitë negociuese" në qershor, dhe "Praktikat më të mira të drejtimit" në shtator 2012.

